



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.qpz.gov.al

Nr.13

28 shkurt

2011

P Ë R M B A J T J A

	Faqe
Ligj nr.10 369 datë 10.2.2011	Për ratifikimin e “Marrëveshjes së ndihmës ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës për qeverisjen me drejtësi dhe në mënyrë demokratike, investimin në njerëz dhe rritjen ekonomike” 321
Ligj nr.10 370 datë 10.2.2011	Për ratifikimin e “Marrëveshjes kulturore ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Bullgarisë për ngritjen e një qendre kulturore dhe informacioni të Republikës së Shqipërisë në Sofje dhe të një qendre kulturore dhe informacioni të Republikës së Bullgarisë në Tiranë” 335
Ligj nr.10 371 datë 10.2.2011	Për ratifikimin e memorandumit për garancitë ligjore dhe juridike kundër përpunimit të paligjshëm të të dhënave personale 338
Ligj nr.10 372 datë 10.2.2011	Për aderimin e Republikës së Shqipërisë në marrëveshjen ndërmjet qeverive të vendeve pjesëmarrëse të Bashkëpunimit Ekonomik të Detit të Zi (BEDZ) për bashkëpunimin në ndihmën dhe përgjigjen ndaj emergjencave të fatkeqësive natyrore ose të shkaktuara nga njeriu dhe në protokollin shtesë të saj 341
Ligj nr.10 373 datë 10.2.2011	Për një shtesë në ligjin nr.7767, datë 9.11.1993 “Për aderimin në konventën “Për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave” 352

LIGJ
Nr.10 369, datë 10.2.2011

**PËR RATIFIKIMIN E “MARRËVESHJES SË NDIHMËS NDËRMJET KËSHILLIT TË
MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË SHTETEVE TË
BASHKUARA TË AMERIKËS PËR QEVERISJEN ME DREJTËSI DHE NË MËNYRË
DEMOKRATIKE, INVESTIMIN NË NJERËZ DHE RITJEN EKONOMIKE”**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet “Marrëveshja e ndihmës ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës për qeverisjen me drejtësi dhe në mënyrë demokratike, investimin në njerëz dhe rritjen ekonomike”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.6897, datë 22.2.2011 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bamir Topi**

Marrëveshje e ndihmës së USAID-it nr.182-AOAG-10-001-000

MARRËVESHJE NDIHME

**NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE
QEVERISË SË SHTETEVE TË BASHKUARA TË AMERIKËS PËR QEVERISJEN ME DREJTËSI
DHE MËNYRË DEMOKRATIKE, INVESTIMIN NË NJERËZ DHE RITJEN EKONOMIKE**

Datë 30 shtator 2010

Ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, që vepron ndërmjet Ministrisë së Financave (këtu më poshtë referuar si “Marrësi i grantit”) dhe Qeverisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës, që veprojnë nëpërmjet Agjencisë së Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID).

Neni 1

Qëllimi

Qëllimi i kësaj Marrëveshjeje të grantit (Marrëveshja) është vendosja e një mirëkuptimi ndërmjet palëve të përmendura më sipër (palët) në lidhje me objektivat e përshkruar në vijim.

Neni 2

Objektivat funksionalë dhe rezultatet

Seksioni 2.1. Objektivat funksionalë. Në mënyrë që të çojë përpara objektivat e ndihmës së huaj për qeverisjen me drejtësi dhe në mënyrë demokratike, investimin në njerëz dhe rritjen

ekonomike (objektivat), palët bien dakord të punojnë së bashku duke i përqendruar aktivitetet në fushat: e shëndetësisë, shtetit ligjor, qeverisjes së mirë dhe rritjes së sektorit privat.

Objektivat e referuar në seksionin 2.1 mund të mos ndryshohen përveçse me anë të amendimit formal me shkrim të kësaj Marrëveshjeje nga përfaqësuesit e autorizuar, siç përcaktohet në seksionin 7.2.

Seksioni 2.2. Rezultatet. Me qëllim arritjen e objektivave, palët bien dakord të punojnë së bashku për të arritur rezultatet e mëposhtme (secili referuar si “Rezultati” dhe së bashku si “Rezultatet”):

- a) Përmirësim të ofrimit të kujdesit shëndetësor në Shqipëri;
- b) Forcim të shtetit ligjor;
- c) Nxitje të qeverisjes së mirë; dhe
- d) Përmirësim të konkurrueshmërisë dhe të rritjes së sektorit privat në Shqipëri.

Seksioni 2.2 mund të ndryshojë me anët të marrëveshjes me shkrim nga ana e përfaqësuesve të autorizuar të palëve pa amendim formal të kësaj Marrëveshjeje.

Seksioni 2.3. Shtojca 1, përshkrim i zgjeruar. Shtojca 1 që bashkëlidhet këtu, është pjesë e kësaj Marrëveshjeje dhe plotëson objektivat e mësipërm, dhe përshkruan aktivitetet dhe rezultatet e pritshme në secilën prej fushave të programit. Brenda kufijve të përcaktimeve të objektivave të parashtruar në seksionin 2.1, shtojca 1 mund të ndryshohet vetëm me marrëveshje me shkrim të përfaqësuesve të autorizuar të palëve pa amendimin formal të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 3

Kontributet e palëve

Seksioni 3.1. Kontributi i USAID-it

a) Granti. Për të ndihmuar arritjen e objektivave të parashtruar në këtë Marrëveshje dhe sipas aktit të ndihmës së huaj të vitit 1961, siç është amenduar, nëpërmjet kësaj, në këtë vit fiskal (VF) 2010 i jep marrësit të grantit, sipas kushteve të marrëveshjes, një sasi që nuk tejkalon shumën e dy milionë e shtatëqind e pesëdhjetë e tre mijë e katërqind e gjashtëdhjetë e nëntë dollarëve amerikanë (USD) (2,753,469\$) (granti).

b) Kontributi total i përlllogaritur i USAID-it. Kontributi total i përlllogaritur i USAID-it për përmbushjen e objektivave do të jetë shtatëdhjetë e pesë milionë dollarë amerikanë (75,000,000 \$), të cilat do të jepen me shtesa. Rritjet pasuese do të jenë të kushtëzuara nga disponueshmëria e fondeve të USAID-it, për këtë qëllim dhe mund të jepen nga USAID-i me anë të njoftimit me shkrim dërguar marrësit të grantit. Palët bien dakord që kontributi shtesë i dhënë, nëse ka, do të rritin në mënyrë shtuese sasinë totale të grantit të parashtruar në seksionin 3.1(a). Marrësi i grantit bie dakord të njoftojë me shkrim USAID-in për secilin kontribut shtesë, nëse ka.

c) Fondet do të disbursohen si nëndetyrime partnerëve zbatues të përzgjedhur në mënyrë konkurruese, siç shpjegohet në shtojcën 1, seksioni 4, rolet dhe përgjegjësitë.

d) Nëse në çdo kohë USAID-i përcakton se kontributi i tij sipas seksionit 3.1 (a) tejkalon sasinë që praktikisht mund të angazhojë për arritjen e objektivave gjatë vitit fiskal amerikan aktual ose të ardhshëm, USAID-i mund të tërheqë sasinë e tepërt duke njoftuar me shkrim marrësin e grantit, duke zvogëluar kështu sasinë e grantit të parashtruar në seksionin 3.1 (a). Veprimet e ndërmarra në bazë të këtij nënseksioni nuk do të ndryshojnë sasinë totale të përlllogaritur të kontributit të USAID-it të parashtruar në 3.1 (b).

Seksioni 3.2. Kontributi i marrësit të grantit. Marrësi i grantit bie dakord se do të përpiqet të sigurojë ose nxitë sigurimin e mbështetjes me personel, të bashkëpunimit teknik dhe kontributeve të tjera në natyrë, përveç fondeve të siguruara nga USAID-i, sikurse është rënë dakord reciprokisht ndërmjet palëve, në përmbushjen e të gjitha aktiviteteve të nevojshme për arritjen e objektivave.

Neni 4
Data e përfundimit

a) Data e përfundimit, që është 30 shtator 2015, ose ndonjë datë tjetër sipas miratimit me shkrim të palëve, është data në të cilën palët vlerësojnë se do të përfundojnë të gjitha aktivitetet e nevojshme për arritjen e objektivave.

b) Përveç rasteve kur USAID-i mund të bjerë dakord ndryshe me shkrim, USAID-i nuk do të lëshojë ose miratojë dokumentacion që do të autorizonte disbursimin e grantit për shërbime të kryera ose mallra të dhëna pas datës së përfundimit.

Neni 5
Kushtet që i paraprijnë disbursimit

Seksioni 5.1. Disbursimi i parë. Para disbursimit të parë sipas grantit ose me lëshimin nga ana e USAID-it të dokumentacionit sipas të cilit do të bëhet ky disbursim, marrësi i grantit, përveç rasteve kur palët mund të bien dakord ndryshe me shkrim, do t'i japë USAID-it në formë dhe përmbajtje të pranueshme për USIAD-in:

a) Një opinion ligjor të pranueshëm për USAID-in që: i) kjo Marrëveshje është autorizuar në mënyrën e duhur ose e ratifikuar dhe ekzekutuar në emër të marrësit të grantit; ii) kjo Marrëveshje përbën një detyrim të vlefshëm dhe të ligjshëm të marrësit të grantit në përputhje me të gjitha kushtet e saj; dhe iii) të gjitha veprimet dhe miratimet e brendshme të nevojshme për ta bërë të vlefshme këtë Marrëveshje janë marrë nga ose në emër të marrësit të grantit; dhe

b) Një deklaratë të firmosur në emër të personit që është në detyrën ose që vepron në zyrën e marrësit të grantit, specifikuar në seksionin 7.2, që emëron me emër dhe titull çdo përfaqësues shtesë që mund të veprojnë në përputhje me seksionin 7.2.

Seksioni 5.2. Njoftimi. USAID-i do të njoftojë menjëherë marrësin e grantit në lidhje me kohën kur USAID-i ka konstatuar që është plotësuar një kusht paraprirës.

Seksioni 5.3. Data përfundimtare për kushtet paraprirëse. Data përfundimtare për plotësimin e kushteve të specifikuara në seksionin 5.1 është gjashtëdhjetë (60) ditë nga data e kësaj marrëveshjeje ose ndonjë datë e mëvonshme që do të vendoset sipas miratimit me shkrim të USAID-it përpara ose pas përfundimit të datës së mësipërme të përfundimit. Nëse kushtet paraprirëse në seksionin 5.1 nuk janë plotësuar deri në datën përfundimtare të mësipërme, USAID-i mund ta përfundojë marrëveshjen me anë të një njoftimi me shkrim drejtuar marrësit të grantit.

Neni 6
Marrëveshje të posaçme

Marrësi i grantit bie dakord që kjo marrëveshje dhe ndihma e ofruar më poshtë janë në vijim të Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Shteteve të Bashkuara dhe Qeverisë së Shqipërisë për sa i përket ndihmës ekonomike, teknike dhe të tjera që kanë lidhje me to, e datës 10 qershor 1992 (Marrëveshja Ekonomike Dypalëshe). Të gjitha dispozitat e Marrëveshjes Ekonomike Dypalëshe, përfshirë, por jo të kufizuara nga përjashtimi nga taksat, tatimet, tarifave doganore e të tjera, zbatohet për fondet e disbursuara në lidhje me këtë Marrëveshje. Asgjë në këtë Marrëveshje ka për qëllim të shtrihet përtej përjashtimeve të çdo ndihme, jo veçanërisht të mbuluara nga Marrëveshja Ekonomike Dypalëshe, si dhe nga kjo Marrëveshje. Mekanizmat për zbatimin e përjashtimeve do të specifikohen në dokumentet e zbatimit sipas nenit A, seksioni A.2 të dispozitave standarde. Në rast paqartësie, Marrëveshja Ekonomike Dypalëshe mbizotëron.

Neni 7
Të ndryshme

Seksioni 7.1. Komunikimi. Çdo njoftim, kërkesë, dokument ose komunikim tjetër që secila palë i dorëzon palës tjetër sipas kësaj marrëveshjeje do të jetë me shkrim ose me anë të telefaksit dhe do të konsiderohet e dhënë ose e dërguar kur i dërgohet asaj pale në adresën e mëposhtme:

Drejtuar USAID-it:

Adresa postare:

Mission Director (drejtor i misionit)

Agjencia e Shteteve të Bashkuara për Zhvillim Ndërkombëtar

Ambasada e Shteteve të Bashkuara të Amerikës

Rr.Elbasanit, 103

Tiranë, Shqipëri

Telefax: +355-4-366-394

Drejtuar marrësit të grantit

Adresa postare:

Ministri Ridvan Bode

Ministria e Financës

Bulevardi: “Dëshmorët e Kombit” nr.4

Tiranë, Shqipëri

Telefax: +355-4-228-405/494

Të gjitha këto komunikime do të jenë në gjuhën angleze dhe shqipe, përveç rasteve kur palët bien dakord ndryshe me shkrim. Marrësit e tjerë mund të zëvendësohen për më sipër pas dorëzimit të një njoftimi me shkrim. Në rast paqartësie ose konflikti ndërmjet dy versioneve, gjuha angleze mbizotëron.

Seksioni 7.2. Përfaqësuesit. Për të gjitha qëllimet që kanë të bëjnë me këtë Marrëveshje, marrësi i grantit do të përfaqësohet nga individi që ka pozicionin individual ose vepron si Ministri i Financave dhe USAID-i do të përfaqësohet nga individi që ka pozicionin individual ose vepron si drejtor i misionit, USAID/Shqipëri, secili prej tyre me anë të një njoftimi me shkrim mund të caktojë përfaqësues shtesë për të gjitha veprimet, përveç nënshkrimit të kësaj Marrëveshjeje, nënshkrimit të amendimeve formale ndaj Marrëveshjes.

Emrat dhe pozicionet e përfaqësuesve shtesë të Marrëveshjes me modelin e nënshkrimit në bazë të seksionit 5.1 (b) do t'i jepen USAID-it, i cili mund të pranojë si të autorizuar rregullisht çdo instrument të nënshkruar nga këta përfaqësues shtesë (ose cilido individ që mban ose vepron në detyrën e këtij përfaqësuesi) në përputhje me seksionin 7.2, deri në marrjen e njoftimit me shkrim të revokimit të autoritetit të tyre.

Seksioni 7.3. Shtojca e dispozitave standarde. “Një shtojcë e dispozitave standarde” (shtojca 2) i bashkëngjitet dhe bëhet pjesë e kësaj Marrëveshjeje.

Seksioni 7.4. Gjuha e Marrëveshjes. Kjo Marrëveshje është e përgatitur në gjuhën angleze dhe shqipe. Në rast paqartësie ose konflikti mes dy versioneve, versioni në gjuhën angleze mbizotëron.

Në dëshmi të kësaj, Qeveria e Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe marrësi i grantit, secili duke vepruar nëpërmjet përfaqësuesit të tij të autorizuar rregullisht, kanë bërë që kjo Marrëveshje të nënshkruhet në emrat e tyre dhe të dërgohet në ditën dhe vitin e cituar më sipër.

Këshilli i Ministrave i Republikës së Shqipërisë
MINISTRI I FINANCAVE
Ridvan Bode

Qeveria e Shteteve të Bashkuara të Amerikës
DREJTORI I MISIONIT
Joseph Williams

SHTOJCA 1 PËRSHKRIMI I ZGJERUAR

I. Hyrje

Shtojca 1 përshkruan aktivitetet që duhet të ndërmerren dhe rezultatet që duhen arritur me fondet e detyrueshme sipas kësaj Marrëveshjeje. Asgjë në shtojcën 1 nuk do të interpretohet si amendim i ndonjë prej përcaktimeve ose kushteve të marrëveshjes.

II. Historik

Strategjia e ndihmës së Shteteve të Bashkuara përqendrohet në përparimin e përgjithshëm të Shqipërisë, duke mbështetur forcimin e institucioneve të saj demokratike, duke nxitur begatinë ekonomike dhe përparimin e integritit të saj të mëtejshëm në strukturat europiane dhe euro-atlantike. Nxitja e normave demokratike dhe respektimi i shtetit ligjor janë thelbësore për integrimin euro-atlantik të Shqipërisë, si dhe për stabilitetin rajonal. Qeveria e Shteteve të Bashkuara punon për të përmirësuar efikasitetin e përgjithshëm të sistemit të drejtësisë, për të ndërtuar kapacitete e qeverisjes vendore, për të zvogëluar korrupsionin dhe për të forcuar shoqërinë civile. Rritja ekonomike e qëndrueshme, motori për zhvillimin e Shqipërisë është, gjithashtu, vendimtare për anëtarësimin në Bashkimin Europian (BE) dhe për aftësinë e Shqipërisë që të vazhdojë të jetë një forcë moderatore në Ballkan, prandaj asistenca e Qeverisë së Shteteve të Bashkuara përqendrohet në: tregtinë dhe investimet, sektorin financiar; infrastrukturën (energjinë dhe teknologjinë e informacionit dhe komunikimit); bujqësinë, si dhe konkurrueshmërinë e sektorit privat. Veç kësaj, Qeveria e Shteteve të Bashkuara e përqendron vëmendjen në reformimin e sistemit të kujdesit shëndetësor të Shqipërisë që ta aftësojë atë për t'iu përgjigjur më mirë nevojave të shëndetit publik, duke rritur përdorimin e qendrave shëndetësore në zonat rurale dhe urbane dhe duke përmirësuar ofrimin e shërbimeve thelbësore, përfshirë informacionin mbi planifikimin familjar, si dhe kujdesin shëndetësor për nënën dhe fëmijën.

III. Objektivi i Marrëveshjes, fushat e programit dhe rezultatet për t'u arritur

Objektivat e kësaj Marrëveshjeje synojnë të mbështesin transformimin e Shqipërisë në një demokraci të qëndrueshme sociale dhe ekonomike. Objektivat do të përmbushen përmes zbatimit të aktiviteteve të përzgjedhura nën katër fushat e programit: shëndetësi, shtet ligjor, qeverisje e mirë, si dhe rritja e sektorit privat.

Fusha 1-Shëndetësia

Qëllimi: Ndihma në këtë fushë synon të përmirësojë ofrimin e shërbimeve shëndetësore përmes reformës së sistemit ekzistues të kujdesit shëndetësor.

Në 20 vitet e shkuara reforma e sistemit të kujdesit shëndetësor në Shqipëri është prekur nga të tilla sfida, si ndryshimet demografike dhe nevoja për rritjen e investimeve, strukturave të menaxhimit, infrastrukturës dhe trajnimit.

Aktivitete të propozuara: Aktivitetet do të zbatohen për të përmirësuar kapacitetin e strukturave të qeverisë në menaxhimin e reformave shëndetësore kryesore. Më specifikisht, programi mund të ofrojë disa prej këtyre aktiviteteve ilustruese:

- Reforma e financimit shëndetësor;
- Përmirësim të legjislacionit dytësor;
- Krijim të planeve zbatuese për politikën ekzistuese;
- Reforma model në nivelin parësor ose terciar.

Rezultatet e pritura: Zbatimi i suksesshëm i programit do të përmirësojë ofrimin e kujdesit shëndetësor në Shqipëri. Ka mundësi të japë përfundimet vijuese:

- Sistem financues të kujdesit shëndetësor më efikas;
- Legjislacion dytësor në përputhje me praktikën më të mira të BE-së;
- Planet e veprimit të përshtatshme dhe që ndiqen prej përfaqësuesve të marrësit të grantit;
- Reformat model janë përfunduar dhe përsëriten prej marrësit të grantit.

Fusha 2-Shteti ligjor

Qëllimi: Ndhurma në këtë fushë synon të përmirësojë dhënien e drejtësisë, duke u fokusuar në sistemin gjyqësor, forcimin e organizatave qytetare, si dhe të mbështesë rolin e medias në mbikëqyrjen e përpjekjeve kundër korrupsionit.

Shqipëria ka ndërmarrë një sërë reformash të thella në forcimin e shtetit ligjor dhe të luftës kundër korrupsionit që kanë dhënë rezultate konkrete. Gjithsesi forcimi i shtetit ligjor dhe lufta kundër korrupsionit mbeten sfidat kryesore për Shqipërinë, veçanërisht lidhur me aderimin në BE. Përpjekjet e mëtejshme për forcimin e shtetit ligjor dhe luftës kundër korrupsionit do të rritin investimet potenciale në Shqipëri dhe kapacitetet e vendit për të përballuar presionin konkurrues.

Aktivitete të propozuara: Aktivitetet do të zbatohen për të nxitur transparencën dhe efikasitetin në gjykata dhe për të fuqizuar organizatat e shoqërisë civile për të shërbyer si monitoruese në mbështetje të reformave kundër korrupsionit. Më specifikisht, programi mund të sigurojë ndihmë teknike dhe trajnim:

- për të rritur përdorimin e sallave të gjykatave;
- për të regjistruar tekstualisht seancat gjyqësore;
- për të zvogëluar sasinë e çështjeve të prapambetura gjyqësore përmes përdorimit të teknikave të ndërhyrjes;
- për të vendosur dhe ruajtur edukim të vazhdueshëm ligjor për avokatët;
- për të ngritur një klinikë ligjore për studentët e fakultetit të juridikut për të mësuar më shumë nga ana praktike;
- për të përmirësuar kapacitetet e shoqërisë civile dhe të medias për t'u përfshirë në mbikëqyrjen efektive të operacioneve të qeverisë;

Rezultatet e pritura: Zbatimi me sukses i këtij programi do të forcojë shtetin ligjor në Shqipëri. Ka mundësi të japë përfundimet vijuese:

- dhënie më të ndershme dhe të barabartë të drejtësisë, matur prej përdoruesve të gjykatave;
- transparencë më të madhe në funksionimin e gjykatës, përfshirë përdorim më të pakët të zyrave të gjyqtarëve;
- shoqëri civile nga sektor jofitimprurës plot jetë dhe ndikues, i aftë për të ndikuar politikën e qeverisë kundër korrupsionit;
- përmirësim të profesionalizmit të nëpunësve ligjorë.

Fusha 3-Qeverisja e mirë

Qëllimi: Ndhurma në këtë fushë synon të përmirësojë qeverisjen në nivel kombëtar dhe vendor dhe të nxitë rritjen ekonomike vendore.

Decentralizimi i qeverisjes në Shqipëri ka qenë një sfidë për shkak të një mungese kapaciteti në nivel bashkie, një nevojë për të qartësuar strukturat e financimit ndërqeveritar, si dhe të një nevojë për të forcuar planet për decentralizimin dhe zhvillimin e rrethinave të qyteteve shqiptare.

Aktivitetet e propozuara: Aktivitetet do të zbatohen për të përmirësuar kapacitetin e Qeverisë për të menaxhuar ofrimin e shërbimeve të qytetarëve, si dhe për të përmirësuar platformën për rritjen dhe zhvillimin ekonomik të bashkive shqiptare. Më specifikisht, programi mund të ofrojë disa prej këtyre aktiviteteve ilustruese:

- ndërtimi i kapacitetit të nëpunësve vendorë për menaxhimin e mirë financiar dhe të aseteve;
- përdorimi i ligjit të ri të planifikimit për të sjellë rritje ekonomike të shpejtë;
- hartimi i strategjisë për planifikimin urban në nivel kombëtar përmes rritjes së kapaciteteve në nivel vendor nëpërmjet ligjeve dhe rregulloreve të reja të përdorimit të tokës urbane;
- përmirësimi i vjeljes së të ardhurave përmes menaxhimit efektiv të taksave vendore, duke i sjellë bizneset e regjistruara në përputhje me procedurat dhe ligjet e reja tatimore;
- zbatimi i reformave model në nivel bashkiak.

Rezultatet e pritura: Zbatimi me sukses i programit do të nxitë mirëqeverisjen në nivel kombëtar dhe vendor. Ka të ngjarë të sjellë përfundimet e mëposhtme:

- Menaxhimin më të mirë të pronës publike;

- Nëpunës vendorë më të aftë;
- Eficiencë dhe transparencë më të madhe në planifikimin urban dhe në përgatitjen e planeve rregulluese në nivel qendror dhe vendor;
- Rritje e vjeljes së të ardhurave vendore dhe investimeve bashkiake;
- Reformat model janë përfunduar dhe përsëriten nga marrësi i grantit. Legjislacioni në mbështetje të decentralizimit është miratuar dhe zbatuar në përputhje me praktikën më të mira të BE-së.

Fusha 4-Zhvillimi i sektorit privat

Qëllimi: Ndiheja në këtë fushë synon të nxitë rritjen e qëndrueshme të sektorit privat në Shqipëri, duke u kushtuar vëmendje të veçantë ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme (SME).

Zhvillimi i ndërmarrjeve private në Shqipëri është penguar nga kapaciteti i tyre i dobët konkurrues, mundësia e tyre e kufizuar për të marrë kredi tregtare dhe mjedisi i pafavorshëm i biznesit, i shkaktuar prej konkurrencës së pandershme dhe zbatimit jo të duhur të ligjeve dhe rregulloreve fiskale. Veç kësaj, infrastruktura e dobët (energjetike, e komunikimit dhe e transportit), e drejta e diskutueshme mbi pronën dhe shtetin ligjor, i dobët shkurajojnë investimet e brendshme dhe të huaja.

Aktivitetet e propozuara: Aktivitetet do të zbatohen për të forcuar kapacitetin teknik, menaxherial dhe të marketingut për shoqëritë e synuara; do të lehtësojnë marrjen e kredive tregtare prej SME-ve dhe do të kultivojnë një mjedis lehtësues të favorshëm për zhvillimin e biznesit, për investimet tregtare dhe private, si dhe për konkurrueshmërinë. Më specifikisht, programi mund të ofrojë ndihmë teknike dhe trajnim:

- për të forcuar kapacitetin tregtar dhe investues të ndërmarrjeve private;
- për të përmirësuar mjedisin lehtësues dhe shërbimet për sektorin financiar;
- për të shtuar prodhueshmërinë dhe për të zhvilluar sektorin bujqësor;
- për të shtuar konkurrueshmërinë dhe zhvillimin e ndërmarrjeve jobujqësore;
- për të fuqizuar kapacitetin institucional të Entit Rregullator të Energjisë Elektrike dhe për të ndihmuar Qeverinë e Shqipërisë në ristrukturimin e sektorit energjetik dhe përmirësimin e eficiencës së tregut të energjisë elektrike;

- për të mbështetur zhvillimin e sektorit të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit.

Rezultatet e pritura: Zbatimi i suksesshëm i programit do të përmirësojë konkurrueshmërinë dhe rritjen e sektorit privat në Shqipëri. Ka të ngjarë të sjellë përfundimet e mëposhtme:

- përmirësim të sektorit të konkurrueshmërisë private;
- rritje të prodhueshmërisë dhe prodhimit të ndërmarrjeve;
- forcim të kapacitetit tregtar dhe investues të ndërmarrjeve;
- përmirësim të sektorit lehtësues financiar;
- përmirësim të shërbimeve financiare;
- përmirësim të mjedisit konkurrues të biznesi.

IV. Rolet dhe përgjegjësitë

A. Marrësi i grantit

Në lidhje me kryerjen e aktiviteteve sipas kësaj Marrëveshjeje, marrësi i grantit do të bëjë të gjitha përpjekjet për të siguruar arritjen e objektivave dhe të rezultateve, siç janë shqyrtuar në këtë Marrëveshje. Ndiheja e parashikuar sipas kësaj Marrëveshjeje do të kërkojë që Departamenti i Strategjive dhe Koordinimit të Ndihmës së Huaj (DSKNH) të kryejë koordinimin ndërmjet ministrive përkatëse, sipas nevojës.

B. USAID-i

USAID-i do të koordinojë dhe komunikojë me marrësin e grantit për të arritur me sukses objektivat dhe rezultatet, siç janë shqyrtuar në këtë Marrëveshjeje.

Të gjitha fondet në këtë Marrëveshjeje do t'u disbursohen si nëndetyrime partnerëve zbatues palë të treta të përzgjedhur në mënyrë konkurruese (secili i referuar si "Partner zbatues"). USAID-i do të hyjë në një ose më shumë marrëveshjeje me një ose më shumë partnerë zbatues palë të treta për të zbatuar aktivitetet sipas kësaj Marrëveshjeje. Këto marrëveshjeje mund të përfshijnë grante,

marrëveshje bashkëpunimi dhe kontrata. Partnerët zbatues mund të jenë organizata ose individë lokalë, nga Shtetet e Bashkuara, ndërkombëtare ose shumëkombëshe, qeveritare ose joqeveritare. USAID-i do të përzgjedhë partnerë zbatues në përputhje me rregulloret dhe politikat e USAID-it.

USAID-i do të monitorojë performancën sipas këtyre marrëveshjeve dhe do të monitorojë performancën e partnerëve zbatues dhe ecurinë drejt arritjes së rezultateve.

USAID-i do t'i japë marrësit të grantit informacionin mbi disbursimet që lidhen me këtë marrëveshje në një format dhe përmbajtje të rënë dakord ndërmjet të dyja palëve.

C. Partnerët zbatues

USAID-i do të përzgjedhë partnerët zbatues. USAID-i do të sigurojë që partnerët zbatues të kryejnë zbatimin e aktiviteteve në përputhje me këtë Marrëveshje dhe t'i raportojnë USAID-it në mënyrë të drejtpërdrejtë. Çdo marrëveshje ndërmjet USAID-it dhe një partneri zbatues që është një organizatë, do të jetë në përputhje me këtë Marrëveshje dhe do të përfshijë një plan monitorimi dhe vlerësimi, duke përfshirë treguesit dhe synimet.

V. Plani financiar

Plani financiar (plani financiar) paraqitet më poshtë. Ndryshimet me shkrim në planin financiar mund të bëhen nga ana e përfaqësuesve të autorizuar pa amendim formal të Marrëveshjes, nëse këto ndryshime nuk bëjnë që kontributi i USAID-it të tejkalojë shumën e specifikuar në seksionin 3.1 të Marrëveshjes.

FINANCIMI I NDIHMËS SË HUAJ TË USAID-IT

Fusha e programit	VF 2010	Total VF 2010-2015
1. Shëndetësia		\$11,000,000
2. Shteti ligjor		\$12,000,000
3. Qeverisja e mirë*		\$12,000,000
4. Shoqëria civile		\$1,000,000
5. Tregtia dhe investimet*		\$3,000,000
6. Sektori financiar*	\$ 187,152	\$2,000,000
7. Infrastruktura	\$514,366	\$5,000,000
8. Bujqësia*		\$10,000,000
9. Konkurrueshmëria e sektorit privat	\$1,732,301	\$14,000,000
10. Mbështetja për programin	\$319,650	\$5,000,000
Totali	\$2,753,469	\$75,000,000

*Financimi për këto fusha është përdorur në mënyrë të njëanshme nga USAID-i për vitin fiskal (Vf) 2010. Pritet që financimi i këtyre fushave në të ardhmen të jetë pjesë e kontributit total të USAID-it për këtë Marrëveshje.

VI. Monitorimi dhe vlerësimi

USAID-i do të identifikojë etapat dhe synimet për matjen e performancës së aktiviteteve që do të zbatohen sipas kësaj Marrëveshjeje. Ecuria drejt etapave dhe synimeve do të vlerësohet në bazë vjetore në konsultim me marrësin e grantit. Qëllimi i këtyre synimeve është vlerësimi i shpejtësisë për arritjen e objektivave dhe rezultateve dhe informimi i palëve në lidhje me vazhdimin, rritjen apo përshtatjen e aktiviteteve.

Arritja e objektivit dhe rezultateve për aktivitete specifike do të matet nëpërmjet treguesve dhe synimeve të performancës, të parashtruara në dokumentet e zbatimit.

SHTOJCA 2 DISPOZITAT STANDARDE

Neni A

Përkufizimet dhe dokumentet e zbatimit

Seksioni A.1. Përkufizimet. Siç përdoret në këtë shtojcë, “Marrëveshja” i referohet marrëveshjes së ndihmës ku është bashkëlidhur kjo shtojcë dhe pjesë e së cilës është kjo shtojcë. Termat e përdorur në këtë shtojcë kanë të njëjtin kuptim ose referencë si në Marrëveshje.

Seksioni A.2. Dokumentet e zbatimit. Për të ndihmuar marrësin e grantit në zbatimin e Marrëveshjes, USAID-i herë pas here do të lëshojë dokumente zbatimi (dokumentet e zbatimit) që do të japin informacion shtesë në lidhje me çështjet e deklaruara në këtë Marrëveshje. Palët mund të lëshojnë, gjithashtu, dokumente zbatimi me pëlqimin e përbashkët për të konfirmuar dhe treguar mirëkuptimin e tyre të ndërsjellë mbi aspekte të zbatimit të kësaj marrëveshjeje. Dokumentet e zbatimit gjithashtu mund të lëshohen për të treguar rishikime ose përfundime, të cilat lejohen nga Marrëveshja.

Neni B

Marrëveshje të përgjithshme

Seksioni B.1. Konsulenca. Palët do të bashkëpunojnë për të siguruar arritjen e objektivit dhe rezultateve të kësaj Marrëveshjeje. Për këtë qëllim, palët me kërkesën e secilës, do të shkëmbejnë mendime në lidhje me ecurinë drejt objektivit dhe rezultateve, përmbushjen e detyrimeve sipas kësaj Marrëveshjeje, performancën e ndonjë konsulenti, kontraktuesi ose furnizuesi të angazhuar sipas marrëveshjes dhe çështje të tjera që kanë lidhje me Marrëveshjen.

Seksioni B.2. Ekzekutimi i Marrëveshjes. Marrësi i grantit:

a) do të realizojë Marrëveshjen dhe aktivitetet e kërkuara për t’u ndërmarrë drejtpërdrejt (ose do të nxitë të ndërmerret) prej marrësit të grantit, ose do të nxitë që marrëveshje dhe aktivitete të tilla të realizohen me kujdesin dhe efikasitetin e duhur dhe në përputhje me praktika të shëndosha teknike, financiare dhe menaxhuese, si dhe në përputhje me ato dokumente, plane, specifikime, kontrata, programe ose rregullime të tjera dhe me ndonjë modifikim në to, të miratuar nga USAID-i sipas kësaj Marrëveshjeje; dhe

b) do të sigurojë menaxhim të kualifikuar dhe me përvojë, si dhe trajnim të stafit, si të jetë më e përshtatshme, për mbështetjen dhe funksionimin e aktiviteteve të financuara nga Marrëveshja, dhe siç është e zbatueshme për aktivitetet e vazhdueshme, do të nxitë funksionimin dhe mbështetjen e atyre aktiviteteve, në mënyrë që të sigurojë arritjen e vazhdueshme dhe të suksesshme të objektivit dhe rezultateve sipas marrëveshjes.

Seksioni B.3. Shfrytëzimi i mallrave dhe shërbimeve. Çdo mall dhe shërbim i financuar nga kjo Marrëveshje, nëse USAID-i nuk bie dakord ndryshe me shkrim, do t’i kushtohet Marrëveshjes deri në përfundimin ose mbarimin e Marrëveshjes, dhe më pas (si dhe gjatë ndonjë periudhe pezullimi të Marrëveshjes) do të përdoret për të nxitur objektivin dhe rezultatet e marrëveshjes ose siç mund të urdhërojë USAID-i në dokumentet e zbatimit.

Seksioni B.4. Tatimi

a) Çlirimi nga detyrimi i përgjithshëm. Marrëveshja dhe asistenca nën të çlirohen nga çdo taksë e vendosur sipas ligjeve në fuqi në territorin e marrësit të grantit.

b) Përveç rasteve kur parashikohet ndryshe në këtë depozitë, çlirimi nga detyrimi i përgjithshëm në nënseksionin (a) zbatohet, por nuk kufizohet ndaj: 1) çdo aktiviteti, kontrate, granti ose marrëveshjeje tjetër zbatuese të financuar nga USAID-i, sipas kësaj Marrëveshjeje; 2) çdo transaksioni ose furnizimi, pajisjeje, materiale, prone ose mallrave të tjera (në vijim të referuara së bashku “mallra”), sipas pikës 1 më sipër; 3) çdo kontraktuesi, marrësi granti ose organizate tjetër

që kryen aktivitete të financuara nga USAID-i sipas kësaj Marrëveshjeje; 4) çdo punonjësi të këtyre organizatave; dhe 5) çdo kontraktuesi ose marrësi granti individual që kryen aktivitete të financuara nga USAID-i sipas kësaj Marrëveshjeje.

c) Përveç rasteve kur parashikohet ndryshe në këtë dispozitë, çlirimi nga detyrimi i përgjithshëm në nënseksionin (a) zbatohet, por nuk kufizohet për taksat e mëposhtme:

1. Çlirimi nga detyrimi 1. Taksat doganore, tarifat, taksat e importit ose taksa të tjera mbi importimin, përdorimin dhe rieksporimin e mallrave ose sendeve personale (duke përfshirë automobilat që janë pronë private) për përdorim vetjak të individëve jo vendas ose të anëtarëve të familjeve të tyre. Përjashtimi 1 përfshin, por nuk kufizohet për të gjitha tarifat, bazuar në vlerën e atyre mallrave të importuara, por nuk përfshin tarifat e shërbimit të lidhura në mënyrë të drejtpërdrejtë me shërbimet e kryera për transferimin e mallrave ose ngarkesës së mallrave.

2. Çlirimi nga detyrimi 2. Taksat mbi të ardhurat, përfitimet ose pasurinë e të gjitha (ë): (i) organizatave jokombëtare të çdo lloji; (ii) punonjësve jo vendas të organizatave kombëtare dhe jokombëtare; ose (iii) kontraktuesve dhe marrësve të grantit jokombëtarë individualë. Çlirimi nga detyrimi 2 përfshin të ardhurat dhe taksat e sigurimeve shoqërore të të gjitha llojeve dhe të gjitha taksat mbi pasurinë, personale ose të patundshme, të zotëruar nga ato organizata ose persona jo vendas. Termi “kombëtar” i referohet organizatave të krijuara sipas ligjeve të marrësit të grantit dhe shtetasve të vendit marrës të grantit, të ndryshëm nga shtetasit e huaj me banim të përhershëm në Shtetet e Bashkuara.

3. Çlirimi nga detyrimi 3. Taksat e vendosura mbi transaksionin e fundit për blerjen e mallrave ose shërbimeve të financuara nga USAID-i sipas kësaj Marrëveshjeje, duke përfshirë taksat e shitjeve, tatimin mbi vlerën e shtuar (TVSH) ose taksat mbi blerjet ose shumave të qirasë të pasurisë së patundshme ose personale. Termi “transaksion i fundit” i referohet transaksionit të fundit, me anë të të cilit mallrat ose shërbimet janë blerë për përdorim në aktivitetet e financuara nga USAID-i në bazë të kësaj Marrëveshjeje.

d) Nëse një taksë është vendosur dhe paguar në kundërshtim me dispozitat e një çlirimi nga një detyrim, USAID-i brenda fushës së veprimit të tij: 1) mund të kërkojë që marrësi i grantit t'i kompensojë USAID-it ose të tjerëve kur USAID-i mund të urdhërojë sasinë e kësaj takse me fonde të ndryshme nga ato të siguruara sipas Marrëveshjes; ose 2) mund të kompensojë sasinë e kësaj takse nga sasinë që do të disbursohen sipas kësaj Marrëveshjeje ose marrëveshjesh të tjera ndërmjet palëve.

e) Në rast të ndonjë mosmarrëveshjeje në lidhje me aplikimin e një çlirimi nga detyrimi, palët bien dakord të takohen menjëherë dhe t'i zgjidhin këto çështje, udhëhequr nga parimi që ndihma e dhënë nga USAID-i të çlirohet nga tatimi i drejtpërdrejtë, në mënyrë që e gjithë ndihma e dhënë nga USAID-i të kontribuojë në mënyrë të drejtpërdrejtë në zhvillimin ekonomik të vendit të marrësit të grantit.

Seksioni B.5. Raportet dhe informacioni, librat dhe regjistrat e Marrëveshjes, kontrollet financiare dhe inspektimet

a) Raportet dhe informacioni. Marrësi i grantit do t'i japë USAID-it regjistra llogarie dhe informacione e raporte të tjera të ngjashme në lidhje me Marrëveshjen, siç mund të kërkojë USAID-i në mënyrë të arsyeshme.

b) Nën marrësit e tjerë të mbuluar. Për nën marrësit “të mbuluar”, të cilët marrin fonde sipas marrëveshjes në bazë të kontratave ose marrëveshjeve të drejtpërdrejta me USAID-in, USAID-i do të përfshijë kërkesa të përshtatshme kontrolli financiar në ato kontrata ose marrëveshje dhe në emër të marrësit të grantit do të kryejë aktivitete përforcuese në lidhje me raportet e kontrollit financiar, të dhëna sipas këtyre kërkesave.

c) Kostoja e kontrolleve financiare. Në bazë të miratimit me shkrim nga USAID-i, kostot e kontrolleve financiare të kryera në përputhje me kushtet e këtij seksioni, mund t'i faturohen Marrëveshjes.

Seksioni B.6. Plotësimi i informacionit. Marrësi i grantit konfirmon:

a) se faktet dhe rrethanat për të cilat është informuar USAID-i ose kanë bërë që USAID-i të informohet, gjatë arritjes së marrëveshjes me USAID-in në lidhje me marrëveshjen, janë të sakta dhe të plota dhe përfshijnë të gjitha faktet dhe rrethanat që mund të cenojnë materialisht Marrëveshjen dhe përmbushjen e përgjegjësive sipas kësaj Marrëveshjeje; dhe

b) se do të informojë USAID-in në mënyrë koherente në lidhje me faktet dhe rrethanat që mund të cenojnë materialisht ose ka arsye të besohet se mund të cenojnë marrëveshjen ose përmbushjen e përgjegjësive sipas kësaj Marrëveshjeje.

Seksioni B.7. Pagesa të tjera. Marrësi i grantit konfirmon që asnjë pagesë nuk është marrë ose nuk merret nga ndonjë zyrtar i marrësit të grantit në lidhje me prokurimin e mallrave ose shërbimeve të financuara sipas Marrëveshjes, përveç tarifave, taksave ose pagesave të ngjashme, të vendosura ligjërisht në vendin e marrësit të grantit.

Seksioni B.8. Informacioni dhe markimi. Marrësi i grantit do t'i japë publicitetin e duhur marrëveshjes si një program për të cilin kanë kontribuar Shtetet e Bashkuara, do të identifikojë vendet e aktivitetit të marrëveshjes dhe do të markojë mallrat e financuara nga USAID-i, siç janë përshkruar në dokumentet e zbatimit.

Neni C

Dispozitat e prokurimit

Seksioni C.1. Burimi dhe origjina

a) Përveç rasteve të përmendura këtu, ose në nënmarrëveshjet e lëshuara nga USAID-i, disbursimet e kësaj Marrëveshjeje ose të nënmarrëveshjes së lëshuar nga USAID-i, do të përdoren për të financuar kostot e mallrave dhe shërbimeve që burimin dhe origjinën e tyre dhe në lidhje me furnizuesit e mallrave dhe shërbimeve, kombësinë e tyre, e kanë në Shtetet e Bashkuara. Përjashtimet ndaj këtyre kërkesave përfshijnë transaksionet e prokurimeve lokale në përputhje me politikën e USAID-it ose prokurime të bëra pasi është rënë dakord ndryshe me shkrim nga USAID-i për burimin, origjinën dhe kombësinë.

b) Kostot e monedhës vendase. Disbursimet për kostot e monedhës vendase do të përdoren vetëm për të financuar mallrat dhe shërbimet e kërkuara nga kjo Marrëveshjeje, të cilat përmbushin kërkesën e politikës lokale të prokurimeve të USAID-it që do të sigurohet në një dokument zbatimi.

c) Burimi dhe origjina e mjeteve të transportit oqeanik dhe ajror do të jetë vendi i regjistrimit të mjeteve të transportit oqeanik ose ajror në kohën e dërgesës.

d) Dispozitat në lidhje me mallrat dhe shërbimet e kufizuara dhe të papranueshme mund të sigurohen në një dokument zbatimi.

e) Transporti ajror i pasurisë ose personave të financuar sipas kësaj Marrëveshjeje do të jetë në mjetet e transportit që mbajnë vërtetimin e Shteteve të Bashkuara, në masën që shërbimi nga ato mjete transporti të jetë në dispozicion sipas aktit amerikan të fluturimit. Kjo kërkesë mund të përshkruhet më tej nga USAID-i në dokumentet e zbatimit.

Seksioni C.2. Data e pranimit. Asnjë mall ose shërbim që nuk është prokuruar sipas urdhrave ose kontratave të vendosura ose të lidhura përfundimisht para datës së kësaj Marrëveshjeje, përveç kur palët mund të bien dakord ndryshe me shkrim, nuk mund të financohet sipas Marrëveshjes.

Seksioni C.3. Çmimi i arsyeshëm. Vetëm çmimet e arsyeshme do të paguhet për çdo mall ose shërbim të financuar, tërësisht ose pjesërisht nga Marrëveshja. Këta artikuj do të prokurohen në mënyrë të ndershme dhe në shkallën maksimale të mundshme, mbi baza konkurrueshmërie.

Seksioni C.4. Njoftim i furnizuesve të mundshëm. Për të lejuar të gjitha firmat e Shteteve të Bashkuara të kenë mundësinë të marrin pjesë në furnizimin e mallrave dhe shërbimeve që do të financohen sipas Marrëveshjes, marrësi i grantit do t'i japë USAID-it këtë informacion në lidhje me këtë dhe në kohën kur USAID-i mund ta kërkojë në dokumentet e zbatimit.

Seksioni C.5. Transporti

a) Përveç kërkesave në seksionin C.1 (a), kostot e transportit oqeanik ose ajror dhe shërbime të ngjashme dërgimi mund të mos financohen nga Marrëveshja, nëse kostot janë për transportin me një anije oqeanike ose avion çarter, që nuk kanë marrë miratimin paraprak të USAID-it.

b) Nëse USAID-i nuk vendos që anijet oqeanike tregtare private me flamurin e Shteteve të Bashkuara nuk janë në dispozicion me çmime të drejta dhe të arsyeshme për ato anije, ose bie dakord ndryshe me shkrim:

1. të paktën pesëdhjetë për qind (50%) e tonazhit bruto të të gjitha mallrave (të llogaritura veçmas për anijet e transportit të mallrave të ngurta, anijet e ngarkesës për mallra të ngurta dhe anijet cisternë), të financuara nga USAID-i që mund të transportohen me anije oqeanike, do të transportohen me anije tregtare private me flamurin e Shteteve të Bashkuara; dhe

2. të paktën pesëdhjetë për qind (50%) e të ardhurave bruto të ngarkesës së mallrave të gjeneruara nga të gjitha ngarkesat e financuara nga USAID-i dhe të transportuara në territorin e marrësit të grantit në anije ngarkese për mallrat e ngurta do të paguhet për ose në interes të anijeve tregtare private që mbajnë flamurin e Shteteve të Bashkuara. Përputhshmëria me kërkesat 1 dhe 2 të këtij nënseksioni duhet të arrihet në lidhje me çdo ngarkesë të transportuar nga portet e Shteteve të Bashkuara dhe çdo ngarkesë të transportuar nga portet joamerikane, të llogaritur veçmas.

Seksioni C.6. Sigurimet

a) Sigurimet e marinës për mallrat e financuara nga USAID-i që duhet të transportohen për në territorin e marrësit të grantit, mund të financohen nga kjo Marrëveshje si kosto të kursit të këmbimit, me kusht që:

1. këto sigurime të jenë vendosur në tarifën më të favorshme dhe konkurruese të mundshme;
2. këto sigurime të jenë vendosur në një vend që është autorizuar sipas seksionit C.1 (a);

dhe

3. tarifat më poshtë janë të pagueshme në dollarë amerikanë ose në ndonjë valutë lirisht të këmbyeshme, nëse USAID-i nuk bie dakord ndryshe me shkrim.

Nëse marrësi i grantit (ose qeveria e marrësit të grantit), me statut, dekret, rregull, rregullore ose praktikë bën dallime në lidhje me prokurimin e financiar nga USAID-i kundër çdo kompanie sigurimesh detare, të autorizuar për të bërë biznes në çdo shtet të Shteteve të Bashkuara, atëherë të gjitha mallrat e ngarkuara për në territorin e marrësit të grantit të financuar nga USAID-i më poshtë, do të sigurohen kundër rreziqeve detare dhe çdo sigurim do të vendoset në Shtetet e Bashkuara me një kompani ose kompani të autorizuar për të bërë biznes sigurimi detar në Shtetet e Bashkuara.

b) Përveç rasteve kur USAID-i mund të bjerë dakord ndryshe me shkrim, marrësi i grantit do të sigurojë ose do të nxitë sigurimin e mallrave të financuara nga Marrëveshja, të importuara për marrëveshjen kundër rreziqeve të mundshme për transitin e tyre në pikën e përdorimit të tyre sipas Marrëveshjes; këto sigurime do të lëshohen në bazë të kushteve dhe termave në përputhje me praktikën e shëndoshë tregtare dhe do të sigurojnë vlerën e plotë të mallrave. Çdo zhdëmtim i marrë nga marrësi i grantit, sipas këtij sigurimi, do të përdoret për të zëvendësuar ose riparuar çdo dëm material ose humbje të mallrave të siguruara ose do të përdoret për të rimbursuar marrësin e grantit për zëvendësimin ose riparimin e këtyre mallrave. Çdo zëvendësim i tillë do të jetë burimi dhe origjina e vendeve të renditura në kodin gjeografik 935 të USAID-it, siç është në fuqi në kohën e zëvendësimit dhe, përveç rasteve kur palët mund të bien dakord ndryshe me shkrim, do të jetë objekt i dispozitave të Marrëveshjes.

Seksioni C.7. Pronësia e tepërt që i përket Qeverisë së Shteteve të Bashkuara, marrësi i grantit bie dakord që kudo që të jetë e zbatueshme, pronësia personale e tepërt që i përket Qeverisë së Shteteve të Bashkuara, në vend të artikujve të rinj të financiar nga Marrëveshja, duhet të përdoret. Fondet sipas Marrëveshjes mund të përdoren për të financuar kostot e përfitimit të kësaj pasurie.

Neni D Disbursimet

Seksioni D.1. Disbursimet. Asnjë disbursim ndaj marrësit të grantit nuk shqyrtohet sipas kësaj Marrëveshjeje. Nëse USAID-i kërkon disbursime për marrësin e grantit në të ardhmen, palët bien dakord ta amendojnë këtë Marrëveshje në mënyrë që ato disbursime të lejohen.

Seksioni D.2. Kursi i këmbimit. Nëse fondet e siguruara sipas Marrëveshjes paraqiten në vendin bashkëpunues nga USAID-i ose çdo agjenci publike ose private për qëllime të kryerjes së detyrimeve të USAID-it më poshtë, marrësi i grantit do të bëjë këto rregullime sipas nevojës, në mënyrë që këto fonde të mund të konvertohen në monedhën lokale në kursin e këmbimit më të lartë të mundshëm, i cili në kohën që është bërë këmbimi, është i ligjshëm në vendin e marrësit të grantit, për çdo person dhe për çdo qëllim.

Neni E Mbarimi, mjetet ligjore

Seksioni E.1. Pezullimi dhe përfundimi

a) Çdo palë mund ta përfundojë këtë Marrëveshje në tërësinë e saj, duke i dhënë palës tjetër një njoftim me shkrim mbi bazën e tridhjetë (30) ditëve. USAID-i, gjithashtu mund ta përfundojë këtë Marrëveshje pjesërisht, duke i dhënë marrësit të grantit një njoftim me shkrim mbi bazën e tridhjetë (30) ditëve dhe ta pezullojë këtë Marrëveshje tërësisht ose pjesërisht, duke i dhënë marrësit të grantit një njoftim me shkrim. Për më tepër, USAID-i mund ta përfundojë këtë Marrëveshjeje, tërësisht ose pjesërisht, duke i dhënë marrësit të grantit njoftim me shkrim, nëse: i) marrësi i grantit nuk arrin t'i përmbahet ndonjë dispozite të Marrëveshjes; ii) ndodh një ngjarje që USAID-i vendos se e bën të pamundur arritjen e objektivit ose rezultateve të Marrëveshjes ose programit të asistencës apo që marrësi i grantit do të jetë në gjendje të përmbushë detyrimet e tij sipas kësaj Marrëveshjeje; ose iii) çdo disbursim ose përdorim i fondeve në mënyrën e shqyrtuar këtu do të ishte në shkelje të legjislacionit në lidhje me USAID-in, qoftë për periudhën aktuale ose më pas në fuqi.

b) Përveç pagesës, të cilën palët janë të angazhuara ta bëjnë sipas angazhimeve të parevokueshme të bëra me palët e treta para këtij pezullimi ose përfundimi, pezullimi ose përfundimi i gjithë kësaj Marrëveshjeje ose i një pjese të saj do të pezullojë (për periudhën e pezullimit) ose përfundojë, si të jetë e zbatueshme, çdo detyrim të palëve për të siguruar burime financiare ose burime të tjera për Marrëveshjen ose për pjesën e pezulluar apo të përfunduar të Marrëveshjes, sipas rastit. Çdo pjesë e kësaj Marrëveshjeje, e cila nuk është pezulluar ose përfunduar, do të mbetet në fuqi të plotë.

c) Për më tepër, pas këtij pezullimi ose përfundimi të plotë ose të pjesshëm, USAID-i, me shpenzimet e USAID-it, mund të urdhërojë që e drejta për mallrat e financuara sipas Marrëveshjes ose sipas pjesës së zbatueshme të Marrëveshjes, të transferohet tek USAID-i nëse mallrat janë në gjendje të dërgohen.

Seksioni E.2. Kompensimet. Çdo kompensim ndaj USAID-it nga një kontraktues, furnizues, bankë ose palë tjetër e tretë në lidhje me mallrat ose shërbimet e financuara nga Marrëveshja, që ka lidhje me një çmim të paarsyeshëm ose faturim të gabuar të mallrave ose shërbimeve, ose për mallrat që nuk kanë qenë në përputhje me specifikimet apo me shërbimet që ishin të pamjaftueshme: (A) do të vihet së pari në dispozicion të Marrëveshjes, në nivel të justifikuar; dhe (B) pjesa që mbetet, nëse ka, do të zbatohet për të ulur sasinë e grantit.

Seksioni E.3. Mosheqja dorë nga mjetet ligjore. Asnjë vonesë në ushtrimin e ndonjë të drejte ose mjete ligjor që rrjedh për një palë në lidhje me financimin e saj sipas kësaj Marrëveshjeje nuk do të interpretohet si një heqje dorë ndaj kësaj të drejte ose mjete ligjor.

Seksioni E.4. Delegimi. Marrësi i grantit bie dakord, sipas kërkesës, të ekzekutojë në delegim ndaj USAID-it të veprimit që mund të lindë ndaj marrësit të grantit në lidhje me ose që rrjedh nga detyrimi kontraktual apo shkelja e performancës nga një palë ndaj një kontrate të

drejtpërdrejtë në dollarë amerikanë, që USAID-i ka financuar tërësisht ose pjesërisht nga fondet e dhëna nga USAID-i, sipas kësaj Marrëveshjeje.

Neni F Të ndryshme

Seksioni F.1. Nxitja e investimeve

a) Përveç kur parashtrahet specifikisht në Marrëveshje ose kur USAID-i autorizon ndryshe me shkrim, asnjë fond ose mbështetje tjetër e parashkuar më poshtë nuk mund të përdoret për ndonjë aktivitet që përfshin nxitjen e investimeve në një vend të huaj.

b) Në rastet kur marrësit të grantit i kërkohet ose dëshiron të sigurojë asistencë në fushën e mësipërme ose kërkon shpjegim nga USAID-i nëse aktiviteti do të ishte në përputhje me kufizimin e parashtruar më sipër, marrësi i grantit duhet të njoftojë USAID-in dhe të sigurojë një përshkrim të hollësishëm të aktivitetit të propozuar. Marrësi i grantit nuk duhet të procedojë me aktivitetin derisa të këshillohet nga USAID-i për ta bërë këtë.

c) Marrësi i grantit duhet të sigurojë që punonjësit e tij dhe nënkontraktuesit dhe nënmarrësit që sigurojnë shërbime për nxitje investimesh si më poshtë, të jenë në dijeni të kufizimeve të parashtruara në këtë klauzolë dhe duhet ta përfshijnë këtë klauzolë në të gjitha nënkontratat dhe nënmarrëveshjet e tjera që janë bërë më poshtë.

Seksioni F.2. Planifikimi familjar vullnetar

Palët bien dakord që të gjitha fondet e USAID-it të siguruara sipas kësaj Marrëveshjeje do të përdoren në përputhje me politikën e zbatueshme të Shteteve të Bashkuara dhe kërkesat statutores në lidhje me projektet e planifikimit familjar vullnetar dhe që asnjë nga fondet e USAID-it të siguruara sipas kësaj Marrëveshjeje apo mallrat, apo shërbimet e financuara nga këto fonde, nuk mund të përdoret për:

a) kryerjen e abortit si një metodë planifikimi familjar ose për të motivuar apo shtrënguar ndonjë person që të praktikojë aborte;

b) kryerjen e sterilizimeve të pavullnetshme si një metodë të planifikimit familjar ose të shtrëngojë apo sigurojë stimuj financiarë ndaj ndonjë personi për të bërë sterilizime; ose

c) çdo kërkim biomjekësor që ka lidhje, tërësisht ose pjesërisht, me metodat ose kryerjen e aborteve apo sterilizimeve të pavullnetshme si një metodë planifikimi familjar.

d) USAID-i do të përgatitë dokumente zbatimi që përshkruajnë në mënyrë më të plotë kërkesat e këtij seksioni.

Seksioni F.3. Ndalimi mbi asistencën ndaj trafikantëve të drogës

a) USAID-i rezervon të drejtën ta përfundojë këtë Marrëveshje ose të marrë masa të tjera të përshtatshme nëse marrësi i grantit ose një individ kyç i grantit rezulton të jetë dënuar për një vepër penale në lidhje me lëndët narkotike ose që është përfshirë në trafikun e drogës, siç përcaktohet në pikën 22 të Kodit të Rregulloreve Federale (CFR), pjesa 140.

b) USAID-i rezervon të drejtën ta përfundojë asistencën ose të marrë masa të tjera të përshtatshme në lidhje me çdo pjesëmarrës të miratuar nga USAID-i, i cili rezulton të jetë dënuar për një vepër penale në lidhje me lëndët narkotike ose që është përfshirë në trafikun e drogës, siç përcaktohet në pikën 22 të Kodit të Rregulloreve Federale (CFR), pjesa 140.

Seksioni F.4. Të drejtat e punëtorëve. Përveç kur parashtrahet specifikisht në Marrëveshje ose kur USAID-i autorizon ndryshe me shkrim, asnjë fond ose mbështetje tjetër e siguruar si më poshtë, nuk mund të përdoret për ndonjë aktivitet që përfshin të drejtat e punëtorëve në një vend të huaj.

Seksioni F.5. Ndalimi për financimin e delegacioneve të qeverive të huaja në konferenca ndërkombëtare. Përveç kur USAID-i i autorizon ndryshe me shkrim, fondet e detyruara sipas kësaj Marrëveshjeje që janë dhënë nga USAID-i nga akti i operacioneve të huaja, financimi i eksporteve dhe programet në lidhje me caktimin e buxheti të çdo viti fiskal amerikan pas vitit fiskal 1999 nuk mund të përdoren për të financiar udhëtimin, dietat, shpenzimet për hotele, vaktet ushqimore, tarifa

konferencë apo kosto të tjera të ngjashme për konferencë për çdo anëtar të një delegacioni të një qeverie të huaj në një konferencë ndërkombëtare të sponsorizuar nga një organizatë ndërkombëtare publike. Ky kufizim mund të shpjegohet më tej nga USAID-i në dokumentet zbatuese.

LIGJ
Nr.10 370, datë 10.2.2011

**PËR RATIFIKIMIN E “MARRËVESHJES KULTURORE NDËRMJET KËSHILLIT TË
MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË REPUBLIKËS SË
BULLGARISË PËR NGRITJEN E NJË QENDRE KULTURORE DHE INFORMACIONI TË
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË SOFJE DHE TË NJË QENDRE KULTURORE DHE
INFORMACIONI TË REPUBLIKËS SË BULLGARISË NË TIRANË”**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet “Marrëveshja kulturore ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Bullgarisë për ngritjen e një qendre kulturore dhe informacioni të Republikës së Shqipërisë në Sofje dhe të një qendre kulturore dhe informacioni të Republikës së Bullgarisë në Tiranë”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.6898, datë 22.2.2011 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bamir Topi**

MARRËVESHJE

**NDËRMJET KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE
REPUBLIKËS SË BULLGARISË MBI NGRITJEN E NJË QENDRE KULTURORE DHE
INFORMACIONI TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË SOFJE DHE NJË QENDRE
KULTURORE DHE INFORMACIONI TË REPUBLIKËS SË BULLGARISË NË TIRANË**

Këshilli i Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeveria e Republikës së Bullgarisë, këtu quhen “palët kontraktuese”,

Kanë rënë dakord si më poshtë:

Neni 1

Palët kontraktuese kanë shprehur pëlqimin e tyre për ngritjen e një qendre kulturore dhe informacioni të Republikës së Bullgarisë në Tiranë dhe të një qendre kulturore dhe informacioni të Republikës së Shqipërisë në Sofje, këtu në tekst të quajtura “qendrat kulturore dhe informative”.

Neni 2

Qendrat kulturore dhe informative i zhvillojnë aktivitetet e tyre në kuadrin e termave të aprovuar nga kjo Marrëveshje dhe në pajtim me ligjet e shtetit, në territorin e të cilit ato ndodhen.

Neni 3

1. Palët kontraktuese sigurojnë hyrje të lirë në ambientet e qendrave kulturore dhe informative dhe në aktivitetet e organizuara prej tyre.

2. Emrat zyrtarë të qendrave kulturore dhe informative mund të përfshihen në pllakate, postera, dokumente dhe mund të përdoren në korrespondencë, në materialet e informimit dhe komunikimit.

3. Secila palë kontraktuese zbaton të gjitha masat e kërkuara, me qëllim që të garantojë funksionimin normal të qendrës kulturore dhe informative të palës tjetër kontraktuese në këtë Marrëveshje.

Neni 4

1. Qendrat kulturore dhe informative mund të zhvillojnë aktivitetet e mëposhtme:

a) Organizojnë një bibliotekë dhe sallë leximi në ambientet e tyre.

b) Nxjerrin dhe importojnë publikime që përmbajnë informacione mbi kulturën dhe shkencat në vendin e saj.

c) Organizojnë shfaqje filmash në dhe jashtë ambienteve të tyre, me asistencën e institucioneve të vendit pritës, kompetent në këtë fushë.

d) Organizojnë në ambientet e tyre aktivitete letrare, shkencore dhe të tjera, të shoqëruara me prezantime vizuale ose muzikore, sipas nevojës.

e) Organizojnë në ambientet e tyre ekspozita fotografish, grafikash, posterash, librash, veprash origjinale të artit dhe riprodhime të artit.

f) Japin shërbime informimi për qytetarët e interesuar të palëve kontraktuese, si dhe për qytetarët e vendeve të treta.

g) Nxjerrin dhe shpërndajnë informacion, buletine në lidhje me ngjarjet dhe aktivitetet e organizuara nga qendrat kulturore dhe informative, duke përfshirë përdorimin e teknologjive të reja të informacionit.

h) Vazhdojnë shkëmbimin e programeve të televizionit dhe radios, në pajtim me marrëveshjet tashmë të zbatueshme të bashkëpunimit ndërmjet institucioneve të palëve kontraktuese.

2. Qendrat kulturore dhe informative mund të japin me qira dhe të shpërndajnë në publik falas materiale sipas pikës 1.g.

Neni 5

Gjatë përmbushjes së aktiviteteve të parashikuara në nenin 4 të kësaj Marrëveshjeje, qendrat kulturore dhe informative respektojnë ligjet e shtetit, në territorin e të cilit ato ndodhen.

Neni 6

1. Qendrat kulturore dhe informative janë qendra publike dhe mënyra e financimit të tyre përcaktohet nga secila palë kontraktuese.

2. Qendrat kulturore dhe informative kanë të drejtën të përfundojnë kontrata në vendet e tyre të pritjes, të nevojshme për funksionimin e tyre.

3. Me qëllim që të mbulojnë shpenzimet e tyre, qendrat kulturore dhe informative mund të gjenerojnë të ardhurat e tyre nga shfaqjet dhe ngjarjet e tjera kulturore.

4. Objektet për ekspozitat të organizuara nga qendrat kulturore dhe informative në ambientet e tyre ose në salla të tjera, si dhe objektet e një natyre kulturore, si: librat, CD-të, kasetat video dhe audio mund të ofrohen për shitje vetëm me kusht që të jenë paguar detyrimet doganore, që mbliidhen nga autoritetet doganore dhe të parashikuara në legjislacionin e zbatueshëm në vendin pritës.

Neni 7

1. Palët kontraktuese japin, mbi bazë reciprociteti, asistencë për identifikimin e ambienteve, ndërtesave dhe parcelave të tokës, të përshtatshme për aktivitetet e qendrave kulturore dhe informative. Termat për marrjen me qira ose përfitimin e këtyre ambienteve, ndërtesave ose parcelave të tokës përcaktohen në pajtim me legjislacionin e zbatueshëm të vendit pritës.

2. Qendrat kulturore dhe informative mund të pajisen me informacion audio-vizual, telekomunikacion dhe mjete të tjera, të kërkuara për zhvillimin e aktivitetit të tyre në pajtim me këtë Marrëveshje.

3. Palët kontraktuese, në pajtim me reciprocitetin dhe respektimin e legjislacionit të zbatueshëm në vendin pritës, i përjashtojnë qendrat kulturore dhe informative nga pagesa e detyrimeve doganore, përveç detyrimeve për formalitetet doganore të zhvilluara jashtë zyrave të tyre, të ngritura për këtë qëllim ose jashtë orarit të punës së organeve doganore, tarifave e magazinimit dhe shërbimeve të një natyre të ngjashme për mallrat e mëposhtme të importuara, që nuk janë destinuar për shitje:

a) Katalogët, posterat, njoftimet, programet, librat, pikturat, regjistrimet LP, materialet audio-vizuale, të kërkuara për funksionimin normal të qendrave kulturore dhe informative;

b) mallrat e importuara përkohësisht: pajisjet teknike, mobiliet dhe materialet, duke përfshirë automjetet e kërkuara për funksionimin e qendrave kulturore dhe informative;

c) filmat që shfaqen në ambientet e qendrave kulturore dhe informative dhe jashtë tyre, në kuadrin e aktiviteteve të organizuara nga qendrat kulturore dhe informative;

d) çdo material tjetër i një natyre kulturore ose informative, që kërkohet për funksionimin e qendrave kulturore dhe informative.

Neni 8

Tatimi i të ardhurave të qendrave kulturore dhe informative rregullohet nga legjislacioni tatimor i vendit pritës, si dhe nga çdo marrëveshje e zbatueshme bilaterale ndërmjet Republikës së Bullgarisë dhe Republikës së Shqipërisë.

Neni 9

1. Palët kontraktuese njoftojnë njëra-tjetrën në lidhje me rritjen e numrit të personelit në qendrat kulturore dhe informative, si dhe për emërimet dhe largimet e anëtarëve të personelit.

2. Punësimi e marrëdhëniet juridike të punonjësve të qendrave përkatëse kulturore dhe informative, të cilët janë shtetas të vendit dërgues, rregullohen nga legjislacioni i punësimit dhe normat e sigurimeve shoqërore të atij vendi.

3. Qendrat kulturore dhe informative kanë të drejtë të punësojnë shtetas të vendit pritës, në pajtim me legjislacionin e zbatueshëm të brendshëm.

Neni 10

1. Secila prej palëve kontraktuese, mbi bazën e reciprocitetit, u ofron individëve të personelit të qendrës kulturore dhe informative të palës tjetër, si dhe bashkëshortëve dhe fëmijëve të tyre që banojnë me ta, të gjitha lehtësitë, në pajtim me legjislacionin e zbatueshëm, për lëshimin në kohë të vizave dhe të lejeve të qëndrimit nga vendi pritës.

2. Lehtësira të ngjashme u jepen edhe pjesëmarrësve në aktivitetet kulturore brenda kuadrit të programeve të aktiviteteve të qendrave kulturore dhe informative.

Neni 11

Çdo mosmarrëveshje në lidhje me interpretimin dhe zbatimin e kësaj Marrëveshjeje zgjidhet me konsultime ndërmjet palëve kontraktuese, si dhe nëpërmjet kanaleve diplomatike.

Neni 12

Kjo Marrëveshje hyn në fuqi në datën e marrjes së njoftimit të dytë, nëpërmjet së cilës palët kontraktuese informojnë reciprokisht njëra-tjetrën nëpërmjet kanaleve diplomatike se janë përmbushur të gjitha kërkesat e parashikuara nga legjislacioni i brendshëm për hyrjen në fuqi të marrëveshjes.

Kjo Marrëveshje zbatohet për një afat kohor prej pesë vjetësh. Vlefshmëria e saj zgjatet automatikisht për çdo periudhë pasuese pesëvjeçare, me kusht që asnjë prej palëve kontraktuese të mos e denoncojë atë me njoftim me shkrim deri në 6 muaj para skadimit të afatit të vlefshmërisë.

Nënshkruar në Tiranë më 23.4.2008, në dy kopje origjinale, secila prej tyre në gjuhën shqipe, bullgare dhe angleze, ku të gjitha tekstet janë njëlloj autentike. Në rastin e mospërputhjeve në interpretim, mbizotëron teksti në gjuhën angleze.

LIGJ

Nr.10 371, datë 10.2.2011

PËR RATIFIKIMIN E MEMORANDUMIT PËR GARANCITË LIGJORE DHE JURIDIKE KUNDËR PËRPUNIMIT TË PALIGJSHËM TË TË DHËNAVE PERSONALE

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Ratifikohet memorandumi për garancitë ligjore dhe juridike kundër përpunimit të paligjshëm të të dhënave personale, bërë në Kishinjë më 31 tetor 2008.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.6899, datë 22.2.2011 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bamir Topi**

MEMORANDUM
PËR GARANCITË LIGJORE DHE GJYQËSORE KUNDËR PËRPUNIMIT TË PALIGJSHËM TË
TË DHËNAVE PERSONALE
Chisinau, 31 tetor 2008

Shtetet anëtare të procesit të bashkëpunimit të Europës Juglindore, nënshkruese të këtij Memorandumi,

duke marrë në konsideratë Konventën për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore, të datës 4 nëntor 1950, Konventën për mbrojtjen e individëve në lidhje me përpunimin automatik të të dhënave personale, të datës 28 janar 1981, protokollin shtesë të Konventës për mbrojtjen e individëve mbi përpunimin automatik të të dhënave personale në lidhje me autoritetet mbikëqyrëse dhe fluksin e të dhënave ndërkuftare, të datës 8 nëntor 2001;

duke iu drejtuar shteteve anëtare që të marrin të gjithë hapat e nevojshëm për të ratifikuar Konventën për mbrojtjen e individëve në lidhje me përpunimin automatik të të dhënave personale, si dhe protokollin shtesë të Konventës;

duke marrë në konsideratë përkufizimet dhe termat e referencës të krijuara në instrumentet e lartpërmendura;

duke theksuar nevojën për të zgjeruar garancitë për të drejtat dhe liritë themelore të çdo individi dhe në veçanti, të drejtën për respektimin e privatësisë, duke marrë në konsideratë fluksin në rritje në kufij të të dhënave personale që i nënshtrohen përpunimit automatik;

duke rikonfirmuar njëkohësisht angazhimin e tyre për lirinë e informacionit pavarësisht nga kufijtë;

duke pranuar se është e nevojshme të pajtohen vlerat themelore të respektimit të privatësisë dhe rrjedhës së lirë të informacionit ndërmjet individëve;

duke theksuar prioritetin e vendosjes dhe garantimit të mjeteve ligjore efektive për individët të cilët janë viktimë të një përpunimi të paligjshëm të të dhënave personale, kanë rënë dakord si më poshtë:

Neni 1

Shtetet palë do të fokusojnë përpjekjet e tyre në forcimin e bashkëpunimit rajonal për promovimin e praktikave të ligjshme në fushat e përpunimit automatik të të dhënave personale.

Çdo palë merr masat e nevojshme në ligjin e saj të brendshëm për t'u dhënë fuqi parimeve bazë për mbrojtjen e të dhënave, të realizuara në sektorët publikë dhe privatë, të përcaktuara në kuadrin ligjor kombëtar dhe ndërkombëtar.

Neni 2

Palët e këtij Memorandumi do të garantojnë, sipas juridiksionit të tyre, për çdo individ të cilësdo kombësie ose vendbanimi, respektimin e të drejtave dhe lirive të tij themelore dhe në veçanti të drejtën e tij për jetën private, mbi përpunimin automatik të të dhënave personale në lidhje me të.

Për të garantuar të drejtën e jetës private, palët do të mbikëqyrin respektimin e parimit të ndershmërisë dhe proporcionalitetit, të nevojshëm për të siguruar akses në informacionin me interes të përgjithshëm dhe rrjedhën e lirë të informacionit ndërmjet individëve.

Neni 3

Palët do t'i garantojnë, në mënyrë të pakushtëzuar, të drejtën për t'u informuar për veprimin e përpunimit dhe për kërkesën e korrigjimit të të dhënave të tij personale, personit, të dhënat e të cilit po përpunohen.

Çdo kufizim mbi ushtrimin e këtyre të drejtave duhet të përcaktohet në ligjin e brendshëm, duhet të ndjekë qëllime të ligjshme dhe nuk duhet të jetë abuziv.

Neni 4

Palët nuk do të lejojnë përpunimin e të dhënave personale në një mënyrë të papajtueshme me qëllimet e ligjshme, me përjashtim të situatës kur ky veprim lejohet shprehimisht nga dispozitat ligjore që janë të nevojshme në një shoqëri demokratike.

Neni 5

Autoritetet kompetente të shteteve palë do të marrin masa teknike dhe organizative të nevojshme për mbrojtjen e të dhënave personale nga përpunimi i tyre i paligjshëm; do t'i garantojnë subjektit të të dhënave akses në dosjet e të dhënave personale, të cilat përpunohen automatikisht dhe për të kundërshtuar përpunimin e të dhënave personale në lidhje me të kur të dhënat përdoren në mënyrë të paligjshme.

Neni 6

Palët do të sigurojnë krijimin dhe funksionimin efektiv të një autoriteti mbikëqyrës të pavarur që monitoron sistemin e mbrojtjes kombëtare dhe gëzon kompetencat e hetimit dhe të ndërhyrjes në procesin e përpunimit të paligjshëm të të dhënave personale.

Neni 7

Palët do t'i garantojnë çdo individ që pretendon të jetë viktimë e një veprimi të paligjshëm në lidhje me përpunimin automatik të të dhënave personale, akses në drejtësi dhe shqyrtimin e çështjes në mënyrë konfidenciale.

Neni 8

Shtetet palë marrin përsipër të vendosin mjete të përshtatshme civile, penale dhe administrative, si dhe sanksione për shkelje të ligjeve kombëtare dhe ndërkombëtare, të cilat i japin fuqi parimeve bazë për mbrojtjen e të dhënave.

Neni 9

Memorandumi hyn në fuqi pas depozitimit të instrumentit të gjashtë të ratifikimit nga shtetet anëtare të procesit të bashkëpunimit të Europës Juglindore.

Nënshkruar në Chisinau, më 31 tetor 2008, në gjuhën angleze, në një kopje të vetme që mbetet e depozituar në arkivat e Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Integritimit Europian të Republikës së Moldavisë. Ministria e Punëve të Jashtme dhe Integritimit Europian e Republikës së Moldavisë i transmeton kopje të vërtetuara çdo shteti anëtar të procesit të bashkëpunimit të Europës Juglindore.

LIGJ
Nr.10 372, datë 10.2.2011

**PËR ADERIMIN E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË NË MARRËVESHJEN NDËRMJET
QEVERIVE TË VENDEVE PJESËMARRËSE TË BASHKËPUNIMIT EKONOMIK TË
DETIT TË ZI (BEDZ) PËR BASHKËPUNIMIN NË NDIHMËN DHE PËRGJIGJEN NDAJ
EMERGJENCAVE TË FATKEQËSIVE NATYRORE OSE TË SHKAKTUARA NGA
NJERIU DHE NË PROTOKOLLIN SHITESË TË SAJ**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 121 të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Republika e Shqipërisë aderon në marrëveshjen ndërmjet qeverive të vendeve pjesëmarrëse të Bashkëpunimit Ekonomik të Detit të Zi (BEDZ) për bashkëpunimin në ndihmën dhe përgjigjen ndaj emergjencave të fatkeqësive natyrore ose të shkaktuara nga njeriu, bërë më 15 prill 1998, dhe në protokollin shtesë të saj, bërë më 20 tetor 2005.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.6900, datë 22.2.2011 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bamir Topi**

MARRËVESHJE

**MIDIS QEVERIVE TË VENDEVE PJESËMARRËSE TË BASHKËPUNIMIT EKONOMIK TË
DETIT TË ZI (BEDZ) MBI BASHKËPUNIMIN NË NDIHMËN DHE PËRGJIGJEN NDAJ
SITUATAVE EMERGJENTE NË FUSHËN E FATKEQËSIVE NATYRORE DHE ATO TË
SHKAKTUARA NGA DORA E NJERIUT**

Qeveritë, palë në këtë Marrëveshje, të referuara si “palë”,
duke marrë parasysh gjasat për shkaktimin e ndonjë situatave emergjente, të cilët palët nuk mund t’i eliminojnë me forcat dhe mjetet e tyre, gjithashtu dhe kërkesën që rrjedh nga ky fakt për veprime të koordinuara të palëve, që kanë si qëllim parandalimin dhe përgjigjen ndaj situatave emergjente;

duke dëshiruar të shtrijnë më tej bashkëpunimin e zhvilluar rajonal për të siguruar ndihmën në rast situatash emergjente dhe për të treguar përpjekje të përbashkëta për të siguruar ndihmë të koordinuar për popullsinë e prekur;

duke mbështetur përpjekjen e Kombeve të Bashkuara në fushën e ndihmës ndërkombëtare ndaj situatave emergjente;

duke respektuar dhe njohur në përgjithësi rregulloret dhe rregullat e pranuar që ekzistojnë në kuadër të organizatave të ndryshme ndërkombëtare, rajonale dhe nënrajonale, konventat dhe marrëveshjet përkatëse ndërkombëtare;

si dhe *me qëllimin* për të kontribuar në përgatitjen e legjislacionit të duhur kombëtar;

duke nxitur më tej bashkëpunimin në fushën e ndihmës ndërkombëtare ndaj situatave emergjente;

bazuar në iniciativat e ndërmarra në Konferencën e Parë të Kryqit të Kuq të Detit të Zi dhe Shoqatat e Gjysmëhënës së Kuqe (1997);

duke shprehur mbështetjen e tyre ndaj idesë për krijimin e një qendre ndërkombëtare shpëtimi të Detit të Zi, duke përdorur eksperiencën e përftuar nga vendet e BEDZ-it dhe të tjera qendra të ngjashme ndërkombëtare,

bien dakord si më poshtë vijon:

Neni 1

Fusha e aplikimit

1. Kjo Marrëveshje vendos parime dhe kuadro ligjorë të aktiviteteve të koordinuara të palëve në raste katastrofash natyrore dhe ato të shkaktuara nga dora e njeriut.

2. Kjo Marrëveshje do të aplikohet në rast katastrofash natyrore dhe ato të krijuara nga dora e njeriut, të cilat nuk mund të eliminohen vetëm me forcat që kanë palët.

Neni 2

Përkufizimet

Për qëllimin e Marrëveshjes së paraqitur, frazat e mëposhtme do të kenë domethënien e tyre të përcaktuar si vijon:

“Ndhimë”, gjëra të nevojshme, materiale, personel dhe shërbime, të siguruar nga pala asistuese duke njohur nevojat e palës kërkuese.

“Pala asistuese”, pala e cila siguron ndihmë.

“Grupi i ndihmës”, grupi i specialistëve të palës asistuese, të cilët kujdesen për të dhënë ndihmë dhe për të pajisur me të gjitha pajisjet e nevojshme.

“Organet kompetente”, agjencia e caktuar nga secila palë për menaxhimin dhe bashkërendimin e aktiviteteve, lidhur me zbatimin e marrëveshjes së paraqitur.

“Fatkeqësi”, një ngjarje në një zonë të caktuar, e cila ka ndodhur si rezultat i një aksidenti, fenomeni të rrezikshëm natyror, katastrofe natyrore apo e shkaktuar nga dora e njeriut, që mund ose u kanë shkaktuar njerëzve ose mjedisit dëmtim të madh fizik, social, ekonomik dhe kulturor.

“Emergjencë”, një situatë, shpesh e rrezikshme, e cila del papritur dhe kërkon një veprim të menjëhershëm.

“Zonë emergjente”, zona në të cilën ka ndodhur një situatë emergjente.

“Reagim emergjent”, kontroll, shpëtim dhe veprimtari të tjera urgjente rikuperuese, të ndërmarra në rast emergjencash, me qëllim shpëtimin e jetëve dhe mbrojtjen e shëndetit të njerëzve, të minimizimit të dëmeve ambientale, kulturore dhe materiale për aq kohe sa rrezikon një impakt dytësor në zonat emergjente.

“Aparatura materiale”, pajisje teknike dhe transporti, municione të grupit të shpëtimit dhe vegla individuale për anëtarët e tij.

“Mjetet e shpëtimit”, materiale rezervë të shpërndara falas dhe pa taksa e këtyre materialeve ndër popullsinë e prekur nga fatkeqësia.

“Informacion personal”, të gjitha llojet e informacioneve të personit fizik, i cili ka lidhje me situatën e pashmangshme emergjente, subjekt i kësaj marrëveshjeje.

“Pala kërkuese”, pala e cila kërkon ndihmë.

“Aktivitete studimore dhe shpëtuese”, aktivitete me qëllim shpëtimin e njerëzve dhe mbrojtjen e vlerave materiale, kulturore dhe ambientale në zonat e emergjencës, duke qenë se këto janë caktuar nga organet kompetente ndërkombëtare.

“Shtete transit”, çdo shtet, qeveria e të cilit është pjesë, ndryshe nga pala kërkuese apo pala asistuese, nëpërmjet territorit të të cilit, duke përfshirë hapësirën ajrore dhe/ose territorin ujor, grupi i ndihmës transporton pajisjet dhe gjërat e nevojshme për ndihmë.

Neni 3 **Parimet**

1. Palët do të bashkëpunojnë, në përputhje me dispozitat ligjore të kësaj Marrëveshjeje, si dhe me rregulloret dhe parimet ndërkombëtare të njohura, me qëllim për të siguruar informacionin përkatës dhe të shpejtë dhe ndihmën në rast katastrofash natyrore dhe ato të shkaktuara nga dora e njeriut dhe/ose gjasat që ato mund të ndodhin.

2. Nëse një palë kërkon ndihmë në rast katastrofash natyrore dhe ato të shkaktuara nga dora e njeriut, që kanë ndodhur në territorin e shtetit të kësaj pale, ajo mund të kërkojë ndihmë nga pala (palët) e tjera duke dërguar kërkesë kombëtare. Pala asistuese do të ndihmojë palën kërkuese me mjete dhe masat që kanë për qëllim parandalimin dhe/ose eliminimin e pasojave nga katastrofat.

3. Palët do t'i japin ndihmë njëra-tjetrës sipas mundësive që kanë. Ndihma do të jepet falas në rast se nuk bihet dakord ndryshe nga palët.

4. Pala kërkuese do të sigurojë marrjen dhe shpërndarjen ekskluzivisht të ndihmës te popullsia e prekur. Ndihma do të shpërndahet pa diskriminim race, besimi, gjuhe, faktorëve politikë dhe faktorëve të tjerë.

Neni 4 **Kërkesa për ndihmë dhe shkëmbim informacioni**

1. Palët do të jenë organet e autorizuar për të kërkuar ndihmë në rast të një situatë emergjente.

2. Ndihma do të jepet pas marrjes së kërkesës, ku pala kërkuese specifikon:

- vendin, kohën, llojin dhe shkallën e katastrofës dhe gjendjen aktuale të situatës emergjente në vendin e prekur;

- veprimet e ndërmarra, specifikimin e ndihmës së kërkuar, përcaktimin e prioriteteve të ndihmës së kërkuar si pasojë e katastrofës.

3. Pala asistuese do të marrë menjëherë një vendim për të dhënë ndihmë dhe të informojë palën kërkuese mbi mundësinë, masën dhe kushtet e dhënies së ndihmës.

4. Informacioni i përmendur në pikën 2 të këtij neni do të rifreskohet sipas zhvillimit të situatës.

Neni 5 **Transiti**

Me kërkesë të palës kërkuese, qeveria e vendit transit do të sigurojë të gjithë mbështetjen e nevojshme gjatë kalimit të ndihmës në territorin e shtetit të saj sipas legjislacionit të saj kombëtar, të drejtën dhe praktikën ndërkombëtare.

Neni 6 **Organet kompetente dhe pikat e kontaktit**

1. Palët do të caktojnë (ose vendosin) një ose disa organe kompetente të referuara si organe kompetente për të koordinuar punën lidhur me zbatimin e kësaj Marrëveshjeje.

2. Pa cenuar marrëveshjet e tjera ekzistuese dy dhe shumëpalëshe, palët do të caktojnë ose vendosin një ose disa pika kontakti kombëtare për të njoftuar dhe për të dhënë ndihmë në rast situatash emergjente.

3. Palët do të njoftojnë njëra-tjetrën me shkrim, nëpërmjet kanaleve diplomatike, për përcaktimin ose ndonjë ndryshim lidhur me organin (organet) kompetent, si edhe mbi pikën (pikat) e kontaktit.

4. Palët do të sigurojnë funksionim të vazhdueshëm të organit (organeve) kompetent dhe pikës (pikave) të kontaktit.

Neni 7

Grupi i punës (komiteti) mbi situatat emergjente

Për zbatimin e kësaj Marrëveshjeje, autoritetet kombëtare kompetente do të caktojnë përfaqësuesit e tyre te një organ përkatës të përbashkët (Komiteti i Grupit të Punës mbi emergjencat) që ngrihet brenda kuadrit të BEDZ-it.

Neni 8

Koordinimi dhe menaxhimi i ndihmës në rast situatash emergjente

1. Organi kompetent i palës kërkuese do të koordinojë, menaxhojë dhe mbikëqyrë aktivitetet e ekipeve të ndihmës nëpërmjet drejtuesve të tyre.

2. Pala kërkuese do të informojë drejtuesit e ekipit të palës asistuese mbi zhvillimin e situatës në zonën emergjente dhe mbi kryerjen e të gjitha aktiviteteve dhe nëse është e mundur, do t'i sigurojë këto ekipe me përkthyes dhe mjete komunikimi.

3. Pala kërkuese do të informojë drejtuesit e ekipit të ndihmës të palës asistuese rreth ndryshimeve të situatës në zonën ku ndodh situata emergjente dhe do të përcaktojë vazhdimësinë e veprimeve dhe nëse është e nevojshme, do të sigurojë përkthyes dhe të tjera mjete komunikimi me zyrën kryesore, që drejton të gjithë aktivitetet e kërkim-shpëtimit dhe aktivitete të tjera urgjente.

4. Ekipet e ndihmës duhet të jenë të vetëpajisura mjaftueshëm për të funksionuar në zonën e situatës emergjente për së paku 72 orë prej momentit të mbërritjes së tyre. Kur kalon ky afat, pala kërkuese, me kërkesën që merr nga ekipet, do të rifurnizojë këto ekipe me të gjitha mjetet e nevojshme.

5. Pala kërkuese do të kujdeset për sigurinë e ekipeve të ndihmës apo individëve-ekspertëve dhe sipas rastit, do të sigurojë përkujdesje mjekësore emergjente, ushqim, akomodim, si edhe produkte bazë për ekipet dhe ekspertët, nëse ata harxhojnë furnizimet e tyre.

Neni 9

Procedura

Procedurat për kalimin në kufi dhe rregullat e qëndrimit për skuadrën asistuese

1. Procesi për kalimin e kufijve shtetërorë të palës së kërkuar ose të shtetit transit nga pjesëtarët e ekipeve të ndihmës duhet të vendoset nga legjislacioni i tyre kombëtar, e drejta ndërkombëtare dhe marrëveshjet dypalëshe të shtetit kërkuar dhe/ose shtetit transit.

2. Urdhri për procedurën e kalimit nëpërmjet kufijve shtetërorë të palës së kërkuar të grupeve të qenve të kërkimit dhe qëndrimin e tyre në territorin e shtetit të palës kërkuese do të përcaktohet në çdo rast në përputhje me rregullat në fuqi mbi karantinën, të territorit të shtetit të palës së kërkuar.

3. Anëtarët e ekipit të ndihmës janë të detyruar të ndjekin ligjet dhe rregullat e shtetit të palës kërkuese dhe/ose shtetit transit. Në të njëjtën kohë ata ndodhen nën juridiksionin e palës asistuese lidhur me legjislacionin e punës dhe legjislacione të tjera përkatëse. Në rast se ekipet e ndihmës përfshijnë personelin paraushtarak të mbrojtjes ushtarake dhe civile, qëndrimi i tyre, siç bihet dakord paraprakisht, si dhe aktivitetet do të bien në legjislacionin e palës asistuese duke rregulluar statusin e çdo personeli.

4. Për qëllime të transportimit të ekipeve të ndihmës, pajisjet dhe ushqimet e tyre të ndihmës, si dhe automjetet e përshtatshme mund të përdoren me qëllim për të mbërritur në destinacion sa më shpejt të jetë e mundur. Urdhri për përdorimin e mjeteve të specifikuara të transportit për mundësimin e ndihmës do të përcaktohet nga organet kompetente të palëve.

Neni 10

Eksporti, importi dhe kalimi transit i aparaturave dhe mjeteve të shpëtimit

1. Aparaturat dhe mjetet e shpëtimit të eksportuara dhe të importuara për ndihmë në përputhje me këtë Marrëveshje do të përjashtohen nga taksat doganore, si dhe nga taksa dhe pagesa të tjera.

2. Inspektimi doganor dhe kontrolli i aparaturave dhe i mjeteve të shpëtimit do të kryhet në një mënyrë të thjeshtëzuar mbi baza prioritare, pas njoftimeve të dhëna nga organet kompetente të palëve, ku specifikohet një strukturë mbi ekipet e ndihmës dhe një listë me aparaturat dhe mjetet e eksportuara ose të importuara për ndihmën.

3. Përbërësit narkotikë dhe substancat psikotrope mund të importohen vetëm në sasi të nevojshme për qëllime të ndihmës mjekësore dhe të përdoren vetëm nga personeli i kualifikuar mjekësor. Në këtë rast drejtuesi i ekipit të ndihmës do t'u dorëzojë organeve të kontrollit doganor një deklaratë, ku përfshihet një listë me përbërësit narkotikë dhe substancat psikotrope, duke treguar nomenklaturën dhe sasinë e tyre. Autoritetet përkatëse të palës së kërkuar mund të kontrollojnë përdorimin dhe ruajtjen e përbërësve narkotikë dhe substancave psikotrope të përmendura sa më lart. Lëndët narkotike dhe substancat psikotrope që nuk përdoren gjatë misionit, do të merren nga territori i shtetit të palës së kërkuar. Pas përfundimit të misionit, organeve të kontrollit doganor do t'u dorëzohet certifikata mbi përbërësit narkotikë dhe substancave psikotrope të përdorura, nënshkruar nga drejtuesi dhe farmacisti i skuadrës së asistencës dhe certifikuar nga përfaqësuesi i organit kompetent të palës së kërkuar.

Neni 11

Mjetet ajrore

1. Transportimi i ekipeve, aparaturave dhe mjeteve të ndihmës mund të kryhet nëpërmjet mjeteve ajrore.

2. Organi kompetent i palës asistuese do të informojë organin kompetent të palës kërkuese mbi vendimin për të përdorur mjetin ajror për të mundësuar ndihmën duke treguar edhe zonën e hedhjes ajrore, rrugën e flurimeve, llojin dhe shenjat përkatëse të mjeteve ajrore, numrin e anëtarëve të ekuipazhit, llojin e ngarkesës, orarin e fluturimeve dhe listën e pasagjerëve (personeli, stafi teknik, gazetarë etj.).

3. Fluturimet e mjetit të lundrimit ajror, civil ose shtetëror do të kryhen në përputhje me Organizatën Ndërkombëtare të Aviacionit Civil dhe rregulloret e palëve. Për mjetet e lundrimit ajror shtetëror, kërkohet leja diplomatike.

4. Pala asistuese përjashtohet nga detyrimi për të paguar për fluturimin, uljen në tokë, parkimin, ngritjen për fluturim dhe shërbimet e pilotimit, që mundëson ndihmë për situatën emergjente, subjekt i kësaj Marrëveshjeje.

5. Për fluturimin që kryhet për të siguruar ndihmë për ngjarjen emergjente, rimbursimi për karburantin, shërbimet e mirëmbajtjes së mjetit të lundrimit ajror do të vendosen veçmas sipas çdo rasti të veçantë.

Neni 12

Ndihma

1. Dhënia e ndihmës do të kryhet sipas parimeve të përshkruara në nenin 3 të kësaj Marrëveshjeje.

Neni 13

Rimbursimi i shpenzimeve të ndihmës në rast të një situatë emergjente e siguruar në baza kompensimi

1. Pala kërkuese mund të anulojë kërkesën e saj për ndihmë në çdo kohë. Pala kërkuese njofton palën asistuese menjëherë mbi vendimin e saj dhe pala asistuese mund të kërkojë rimbursimin e shpenzimeve që janë bërë deri në atë moment.

2. Pala asistuese do të sigurojë kontratë sigurimi për anëtarët e ekipeve të ndihmës dhe këto shpenzime do të përfshihen në faturën totale për ndihmën.

3. Me përfundimin e operacionit, organi kompetent i palës asistuese do të informojë menjëherë me shkrim organin kompetent të palës kërkuese mbi masën e ndihmës së dhënë.

4. Organi kompetent i palës kërkuese do t'i sigurojë organit kompetent të palës asistuese informacionin përfundimtar mbi karakteristikat dhe shkaqet e situatës emergjente, formën dhe masën totale të asistencës të dhënë dhe rezultatet e punës së kryer.

Neni 14

Rimbursimi për dëmtimet

1. Pala kërkuese do të mbulojë të gjitha shpenzimet lidhur me dëmtimin ose vdekjen e pjesëtarëve të ekipeve të ndihmës, që ndodh gjatë aktiviteteve lidhur me zbatimin e kësaj Marrëveshjeje. Palët e interesuara do të bien dakord mbi shumën që do të rimbursohet.

2. Nëse një pjesëtar i ekipit të ndihmës i shkakton dëmtim një entiteti ligjor ose personi fizik në territorin e palës kërkuese gjatë aktiviteteve lidhur me zbatimin e kësaj Marrëveshjeje, dëmtimi do të rimbursohet nga pala kërkuese sipas rregulloreve ligjore në fuqi, duke qenë se ky dëmtim është shkaktuar nga shtetasit e saj gjatë kohës që sigurojnë ndihmën.

3. Dëmtimi i shkaktuar nga një pjesëtar i ekipit të ndihmës, me qëllim ose neglizhencë të rëndë, do të rimbursohet nga pala kërkuese, nëse fakti mbi dëmtimin provohet nga një gjykatë kombëtare e palës kërkuese.

Neni 15

Transferimi i të dhënave personale

Transferimi i të dhënave personale të palët e tjera brenda kuadrit të kësaj Marrëveshjeje do të kryhet sipas shtojcës 1, e cila është pjesë integrale e kësaj Marrëveshjeje.

Neni 16

Bashkëpunimi me organizata/institucione ndërkombëtare dhe kombëtare

1. Bazuar në marrëveshjen e ndërsjellë, palët përkatëse mund të ftojnë organizatat/institucionet e interesuara ndërkombëtare dhe kombëtare për t'iu bashkuar aktiviteteve, lidhur me implementimin e kësaj Marrëveshjeje.

Neni 17

Nënshkrimi

Kjo Marrëveshje është e hapur për nënshkrim nga çdo shtet i BEDZ-it.

Neni 18

Ratifikimi, pranimi, aderimi, aprovimi ose aderimi

1. Marrëveshja do të jetë subjekt i ratifikimit, pranimit, aderimit, aprovimit ose aderimit. Instrumentet e ratifikimit, pranimit, aderimit, aprovimit ose hyrjes do të depozitohen tek depozituesi i kësaj Marrëveshjeje.

2. Depozituesi i kësaj Marrëveshjeje do të jetë Qeveria e Federatës Ruse, e cila do të dërgojë te palët kopje të certifikuara të sa më sipër.

Neni 19

Hyrja në fuqi dhe periudha e vlefshmërisë

1. Kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi kur instrumentet e ratifikimit, pranimit, afirmimit, aprovimit ose aderimit janë depozituar nga së paku 6 shtete dhe përfshihet për një periudhë të pacaktuar kohore.

2. Për secilin shtet që ratifikon, pranon, afirmon, pranon ose aderon në këtë Marrëveshje pas depozitimit të instrumentit të gjashtë të ratifikimit, pranimit, afirmimit, aprovimit ose aderimit, kjo Marrëveshje do të hyjë në fuqi ditën kur shteti depoziton instrumentin e saj të ratifikimit, pranimit, afirmimit, aprovimit ose aderimit.

Neni 20

Tërheqja nga kjo Marrëveshje

1. Palët mund të tërhiqen nga kjo Marrëveshje duke i dërguar një njoftim me shkrim depozituesit, i cili informon palët e tjera mbi këtë fakt.

2. Tërheqja nga Marrëveshja do të bëhet e efektshme në ditën e 90-të pas datës së marrjes së një njoftimi të tillë nga depozituesi.

3. Pala që dëshiron të tërheqë daljen nga kjo Marrëveshje, do të njoftojë depozituesin me shkrim. Njoftimi do të bëhet jo më vonë se 30 ditë pas dorëzimit të aplikimit për tërheqje nga kjo Marrëveshje.

Neni 21

Ndryshimet në Marrëveshje

1. Palët mund të propozojnë ndryshime në këtë Marrëveshje.

2. Propozimi për ndryshime do t'i komunikohet Grupit të Punës (Komitetit) të Emergjencave në formë të shkruar, i përmendur në nenin 7 të kësaj Marrëveshjeje, i cili më pas informon palët mbi këtë qëllim. Në rast se do të ndërmerren veprime të mëtejshme kjo do të specifikohet nga Grupi i Punës (Komiteti) i Emergjencave sipas mandatit të saj të përcaktuar nga palët.

Neni 22

Marrëdhëniet me marrëveshje të tjera ndërkombëtare

Kjo Marrëveshje nuk do të prekë të drejtat dhe detyrimet e palëve të përcaktuara në marrëveshje të tjera ndërkombëtare.

Neni 23

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Në rast mosmarrëveshjeje ndërmjet dy ose më shumë palëve lidhur me interpretimin ose aplikimin e kësaj Marrëveshjeje, palët në fjalë do të zgjidhin mosmarrëveshjen nëpërmjet negociatave dhe, nëse është e nevojshme, nëpërmjet kanaleve diplomatike.

Neni 24
Gjuha e Marrëveshjes

Teksti origjinal i kësaj Marrëveshjeje është hartuar në gjuhën angleze.

Nënshkruar në Sochi, 15 prill 1998.

Për vërtetimin e sa më sipër, kjo Marrëveshje nënshkruhet nga organet e autorizuar si më poshtë vijon:

Për Qeverinë e Republikës së Shqipërisë
Për Qeverinë e Republikës së Armenisë
Për Qeverinë e Republikës së Azerbajxhanit
Për Qeverinë e Republikës së Bullgarisë
Për Qeverinë e Republikës së Gjeorgjisë
Për Qeverinë e Republikës Helenike
Për Qeverinë e Republikës së Moldavisë
Për Qeverinë e Rumanisë
Për Qeverinë e Federatës Ruse
Për Qeverinë e Serbisë
Për Qeverinë e Republikës së Turqisë
Për Qeverinë e Ukrainës

ANEKSI I

Rregullat për shkëmbimin e të dhënave personale në kuadër të kësaj Marrëveshjeje dhe sipas legjislacionit në shtetet e palëve janë si më poshtë vijon:

1. Përdorimi i të dhënave nga pala marrëse lejohet sipas kushteve dhe për qëllimet e përshkruara nga pala dërguese.

2. Pala marrëse do të informojë palën dërguese sipas kërkesës së marrë, duke cituar se si janë përdorur të dhënat personale dhe për rezultatet që janë arritur.

3. Marrësi i të dhënave personale është vetëm organi kompetent. Rishkëmbimi i të dhënave personale mundësohet pas një lejeje me shkrim të palës dërguese.

4. Pala dërguese duhet të transferojë të dhëna korrekte, në përputhje me qëllimet e transferimit të saj, duke marrë parasysh rregulloret kombëtare përkatëse. Kur pala marrëse informohet në rast transferimi të të dhënave jokorrekte ose të klasifikuara, do të korrigojë gabimet ose do të shkatërrojë të gjitha të dhënat.

5. Personat që pësojnë dëmtim për shkak se këto të dhëna i përkasin atij, ka të drejtë të aplikojë për një certifikatë mbi të pas prezantimit të qëllimeve për përdorimin e tyre. Nëse interesat publikë predominojnë interesat e personave të prekur, këto të fundit e humbin të drejtën e përmendur sa më lart. Në raste të tjera, personi ka të drejtë të marrë certifikatën në përputhje me legjislacionin kombëtar në shtetin, territori i të cilit ka qenë vendi i kërkesës.

6. Nëse transferimi i informacionit brenda kuadrit të kësaj Marrëveshjeje shkakton dëmtim fizik ose moral, pala marrëse do të jetë përgjegjëse për të njëjtin faj në përputhje me legjislacionin e saj kombëtar. Në trajtimin e personit (personave) që kanë pësuar një plagosje ose dëmtim të tillë, pala marrëse nuk ka të drejtë të largojë nga vetja përgjegjësinë dhe t'ia kalojë palës dërguese.

7. Periudha e vlefshmërisë së të dhënave personale duhet të njoftohet nga pala dërguese në përputhje me legjislacionin e saj kombëtar.

8. Palët detyrohen të regjistrojnë të dhënat personale hyrëse dhe dalëse si dokumente zyrtare.

9. Palët detyrohen të mbrojnë të dhënat personale sipas klasifikimit të tyre kombëtar, nga hyrja, përdorimi, ndryshimet dhe zbulimi i paautorizuar.

PROTOKOLL SHITESË

I MARRËVESHJES MIDIS QEVERIVE TË VENDEVE PJESËMARRËSE TË BASHKËPUNIMIT EKONOMIK TË DETIT TË ZI (BEDZ) MBI BASHKËPUNIMIN NË NDIHMËN DHE PËRGJIGJEN NDAJ SITUATAVE EMERGJENTE NË FUSHËN E FATKEQËSIVE NATYRORE DHE ATO TË SHKAKTUARA NGA DORA E NJERIUT

Preambul

Qeveritë e vendeve anëtare të Organizatës së Bashkëpunimit Ekonomik të Detit të Zi (BEDZ) - palë në këtë protokoll shtesë, në vijim referuar si “Palët”;

Bazuar mbi dispozitat e neneve 3, 4, 5, 7 dhe 8 të Marrëveshjes ndërmjet qeverive të vendeve pjesëmarrëse në Organizatën e Bashkëpunimit Ekonomik të Detit të Zi mbi bashkëpunimin në ndihmën dhe përgjigjen ndaj situatave emergjente si pasojë e fatkeqësive natyrore dhe ato të shkaktuara nga dora e njeriut, nënshkruar në Sochi më 15 prill 1998, në vijim referuar si “Marrëveshja BEDZ”;

të vetëdijshëm mbi rolin në rritje dhe rëndësinë që kanë strategjitë efektive parandaluese në lidhje me bashkëpunimin në fushën e ndihmës ndaj situatave emergjente;

duke theksuar rëndësinë e një politike më efektive, si përgjigje ndaj fatkeqësive dhe kërkesës për bashkëpunim praktik në zvogëlimin e rreziqeve të mëdha dhe parandalimit të fatkeqësive, si dhe në rritjen e veprimit në situatat emergjente;

duke përsëritur vendosmërinë e tyre për të arritur, përmes përpjekjeve të përbashkëta, përmirësimin e zbatimit të dispozitave të marrëveshjes BEDZ;

me qëllimin për të siguruar nivelin e duhur të koordinimit të bashkëpunimit ndërmjet autoriteteve të palëve;

kanë rënë dakord sa më poshtë vijon:

Neni 1

Vendosja e një rrjeti oficerësh kontakti

Palët do të vendosin një rrjet oficerësh kontakti të BEDZ-it mbi asistencën emergjente, në vijim referuar si “Rrjeti”, që konsiston në oficerë kontakti të caktuar nga palët si përfaqësues të tyre.

Neni 2

Objektivat

Objektivat e rrjetit janë siç vijon:

1. Të rrisë bashkëpunimin në fushën e ndihmës në situatat emergjente dhe të sigurojë koordinimin dhe ndërveprimin ndërmjet autoriteteve kompetente të palëve;

2. Të vendosë një rrjet shkëmbimi informacioni ndërmjet organeve të rëndësishme të palëve për të bashkëpunuar në mënyrë efektshme në ndihmën dhe përgjigjen ndaj situatave emergjente në përputhje me marrëveshjen BEDZ.

Neni 3

Detyrat dhe funksionet

Oficerët e kontaktit të rrjetit kanë detyrat dhe funksionet e mëposhtme:

1. Të dërgojnë kërkesat që u vijnë nga oficerë të tjerë kontakti drejt vendeve të tyre respektive për raste urgjente, brenda ditës dhe për raste të tjera, brenda tri ditëve, në përputhje me dispozitat e neneve 4 dhe 5 të marrëveshjes BEDZ;

2. T’u dërgojnë palëve informacionin e kërkuar sipas kërkesës, në përputhje me dispozitat e nenit 4 të marrëveshjes BEDZ;

3. Të takohen periodikisht për të vlerësuar tendencat e asistencës ndaj situatave emergjente dhe përgjigjen ndaj situatave emergjente në rajon, me qëllim për të identifikuar forma të reja bashkëpunimi mes organeve përkatëse të vendeve anëtare të BEDZ-it;

4. T'u raportojnë dhe propozojnë organeve respektive mënyrat për të rritur më tej bashkëpunimin;

5. Të lehtësojnë shkëmbimin e eksperiencës praktike mes organeve përkatëse të palëve në fushën e asistencës dhe përgjigjes ndaj situatave emergjente.

Neni 4

Statusi i rrjetit brenda BEDZ

Rrjeti është një grup bashkëpunimi në sferën e asistencës ndaj situatave emergjente, i krijuar në përputhje me dispozitat e nenit 7 të marrëveshjes BEDZ.

Neni 5

Vendi i takimeve të rrjetit

Rrjeti do t'i mbajë takimet në zyrat e përhershme të Sekretariatit Ndërkombëtar të BEDZ-it, nëse nuk vendoset ndryshe me iniciativën e drejtuesit të BEDZ-it ose me vendim të ministrave të punëve të jashtme.

Neni 6

Organizimi dhe funksionimi

1. Rrjeti do të funksionojë në përputhje me kartën dhe rregullat e procedurës së BEDZ-it, si dhe dispozitat e marrëveshjes BEDZ.

2. Secila palë në këtë protokoll shtesë do të caktojë një oficer kontakti dhe alternatin e tij/saj në rrjet.

3. Pas caktimit ose tërheqjes së oficerëve të kontaktit në rrjet, palët do të njoftojnë Sekretariatit e Përhershëm Ndërkombëtar të BEDZ-it në mënyrë që të informohen të gjitha vendet anëtare.

4. Rrjeti do të mbledhet periodikisht të paktën një herë në vit.

5. Rrjeti do të kryejë detyrat e tij nën autoritetin e grupit të punës për bashkëpunim në ndihmën ndaj situatave emergjente dhe do t'i raportojë atij.

Neni 7

Shpenzimet

Të gjitha shpenzimet e oficerit të kontaktit që lidhen me implementimin e dispozitave të këtij protokollit shtesë do të përballohen nga pala dërguese.

Neni 8

Pikat kombëtare të kontaktit

Palët do të caktojë një pikë kombëtare kontakti brenda organizmave të tyre kompetente, preferohen ata që merren me bashkëpunimin ndërkombëtar.

Neni 9

Vëzhguesit dhe të ftuarit

1. Përfaqësuesit e shteteve vëzhguese të BEDZ-it mund të marrin pjesë në punën e rrjetit, në përputhje me kartën dhe rregullat e procedurës të BEDZ-it.

2. Në mbledhjen e rrjetit mund të ftohen të marrin pjesë edhe institucione ose agjenci ndërkombëtare përkatëse.

Neni 10
Dispozitat përfundimtare

1. Ky protokoll shtesë është i hapur për nënshkrim ose pjesëmarrje nga çdo vend anëtar i BEDZ-it.

2. Sekretariati Ndërkombëtar i Përhershëm i BEDZ-it do të jetë depozituesi i këtij protokoll shtesë.

Originali i këtij protokoll shtesë, i përbërë nga një kopje teke në gjuhën angleze, do të depozitohet në Sekretariatit Ndërkombëtar të Përhershëm, i cili do t'i dëgojë çdo palë një kopje të certifikuar.

3. Ky protokoll shtesë do të hyjë në fuqi në ditën e tridhjetë pas datës, në të cilin dokumenti i tretë i ratifikimit ose miratimit depozitohet në Sekretariatit Ndërkombëtar të Përhershëm të BEDZ-it.

4. Për secilën palë, që ratifikon, miraton ose merr pjesë në këtë protokoll shtesë, pas depozitimit të dokumentit të tretë të ratifikimit, miratimit ose pjesëmarrjes, ky protokoll shtesë do të hyjë në fuqi në ditën e tridhjetë pas datës së depozitimit të dokumentit të ratifikimit aprovimit ose pjesëmarrjes nga kjo palë.

5. Çdo palë mund të heqë dorë nga ky protokoll shtesë me një njoftim me shkrim dërguar Sekretariatit Ndërkombëtar të Përhershëm të BEDZ-it. Heqja dorë do të hyjë në fuqi tre muaj pas datës në të cilën merret njoftimi i heqjes dorë nga Sekretariati Ndërkombëtar i Përhershëm.

6. Çdo palë mund të propozojë amendime për këtë protokoll shtesë. Amendimet do të pranohen me miratimin e të gjitha palëve dhe do të hyjnë në fuqi në përputhje me paragrafët 3 dhe 4 të këtij neni.

7. Dy vjet nga hyrja në fuqi e këtij protokoll shtesë, palët do të procedojnë me një analizë të rezultateve të zbatimit të dispozitave të këtij protokoll shtesë. Një vlerësim final do të bëhet katër vjet pas hyrjes në fuqi, me qëllimin për të arritur të bihet dakord për masat e nevojshme për përmirësimin e mëtejshëm të bashkëpunimit.

Për Qeverinë e Republikës së Shqipërisë
Për Qeverinë e Republikës së Armenisë
Për Qeverinë e Republikës së Azerbajxhanit
Për Qeverinë e Republikës së Bullgarisë
Për Qeverinë e Republikës së Gjeorgjisë
Për Qeverinë e Republikës Helenike
Për Qeverinë e Republikës së Moldavisë
Për Qeverinë e Rumanisë
Për Qeverinë e Federatës Ruse
Për Qeverinë e Serbisë
Për Qeverinë e Republikës së Turqisë
Për Qeverinë e Ukrainës

LIGJ
Nr.10 373, datë 10.2.2011

**PËR NJË SHITESË NË LIGJIN NR. 7767, DATË 9.11.1993 “PËR ADERIMIN NË
KONVENTËN “PËR ELIMINIMIN E TË GJITHA FORMAVE TË DISKRIMINIMIT NDAJ
GRAVE””**

Në mbështetje të neneve 78, 83 pika 1 dhe 12 pika 1 shkronja “b” të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave,

KUVENDI
I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

VENDOSI:

Neni 1

Në ligjin nr.7767, datë 9.11.1993 “Për aderimin në konventën “Për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave””, shtohet neni 2 me këtë përmbajtje:

“Neni 2

Pranimin nga Republika e Shqipërisë të ndryshimit të nenit 20 paragrafi 1 të konventës “Për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave”, i cili përcakton se Komiteti për Eliminimin e Diskriminimit ndaj Grave (Komiteti CEDAW) duhet të mblidhet normalisht çdo vit, me qëllim shqyrtimin e raporteve të paraqitura në përputhje me nenin 18 të kësaj konvente.”.

Neni 2

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**Shpallur me dekretin nr.6901, datë 22.2.2011 të Presidentit të Republikës së Shqipërisë,
Bamir Topi**

Sesioni i dyzetënëntë
Pika 97 e rendit të ditës

REZOLUTA TË MIRATUARA NGA ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME

49/164. Konventa për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave

Asambleja e Përgjithshme,

duke pasur parasysh se një nga qëllimet e Kombeve të Bashkuara, të shprehura në nenet 1 dhe 55 të Kartës, është të nxisë respektimin universal të të drejtave të njeriut dhe të drejtave themelore për të gjithë pa asnjë lloj dallimi, duke përfshirë dallimin gjinor;

duke konfirmuar se gratë dhe burrat duhet të marrin pjesë në mënyrë të barabartë në zhvillimin social, ekonomik dhe politik, të kontribuojnë në mënyrë të barabartë për një zhvillim të tillë dhe të ndajnë në mënyrë të barabartë kushtet e përmirësuara të jetesës;

duke iu referuar rezolutës së saj 34/180 të datës 18 dhjetor 1979, me anë të së cilës miratoi Konventën për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave;

duke iu referuar edhe rezolutave të saj të mëparshme për Konventën, dhe duke parë rezolutën 1994/7 të Këshillit Ekonomik dhe Social të datës 21 korrik 1994;

duke mirëpritur numrin në rritje të shteteve palë në Konventë, që tashmë janë njëqind e tridhjetë e katër;

duke vërejtur me shqetësim të thellë se Konventa është ende një ndër instrumentet e të drejtave të njeriut me një numër të madh rezervash, shumë prej të cilave bien ndesh me objektin dhe qëllimin e Konventës, pavarësisht faktit se disa prej shteteve i kanë tërhequr rezervat e tyre ndaj saj;

duke iu referuar Deklaratës së Vjenës dhe programit të veprimit, të miratuara nga Konferenca Botërore për të Drejtat e Njeriut të datës 25 qershor 1993, ku Konferenca parashikoi që të drejtat e grave dhe të vajzave ishin pjesë e patjetërsueshme, integrale dhe e pandarë e të drejtave universale të njeriut;

duke iu referuar gjithashtu faktit se në Deklaratën e Vjenës dhe në programin e veprimit, konferenca rekomandoi miratimin e procedurave të reja për forcimin e zbatimit të angazhimit për barazinë e grave dhe për të drejtat e njeriut, duke përfshirë thirrjen ndaj Komisionit për Statusin e Grave dhe Komitetit për Eliminimin e Diskriminimit ndaj Grave për të shqyrtuar me shpejtësi mundësinë e prezantimit të së drejtës së peticionit, nëpërmjet përgatitjes së një protokolli alternativ ndaj Konventës;

duke parë vendimin e miratuar në takimin e gjashtë të shteteve palë në Konventë më 4 shkurt 1992;

të ndërgjegjshëm për rëndësinë e kontributit që zbatimi i strategjive largpamëse të Najrobit për avancimin e grave mund të sjellë eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave dhe arritjen e barazisë ligjore dhe faktike ndërmjet grave dhe burrave;

pasi janë shqyrtuar raportet e Komitetit për Eliminimin e Diskriminimit ndaj Grave në sesionet e tij të dymbëdhjetë dhe të trembëdhjetë;

duke parë sugjerimet dhe rekomandimet e përgjithshme të bëra nga Komiteti në përputhje me mandatin e tij, siç është demonstruar së fundi nga Komiteti në sesionin e tij të trembëdhjetë, në të cilin Komiteti miratoi sugjerimin nr.6 në Konferencën Ndërkombëtare për Popullsinë dhe Zhvillimin dhe rekomandimin e përgjithshëm nr.21 në lidhje me nenet 9, 15 dhe 16 të Konventës si kontribut për Vitin Ndërkombëtar për Familjen, si dhe rekomandime të tjera të përgjithshme të bëra nga Komiteti;

duke parë se ngarkesa e punës së Komitetit është rritur si rrjedhojë e rritjes së numrit të shteteve palë në Konventë, se sesioni vjetor i Komitetit është ende më i shkurtër i të gjitha sesioneve vjetore të organeve të traktateve të të drejtave të njeriut dhe se përveç rekomandimeve të Këshillit Ekonomik dhe Social në rezolutën e tij 1992/17 të datës 30 korrik 1992, që u mbështet nga Asambleja e Përgjithshme në rezolutën e saj 47/94 të datës 16 dhjetor 1992, dhe se do të mundësoheshin tri javë për çdo sesion të Komitetit për të shqyrtuar raportet e dorëzuara nga shtetet palë derisa të jenë eliminuar raportet e prapambetura, ende mbetet punë për t'u bërë;

të bindur për nevojën për të miratuar masa për t'i mundësuar Komitetit që të shqyrtojë në mënyrë të hollësishme dhe në kohë raportet e dorëzuara nga shtetet palë dhe të përmbushë të gjitha përgjegjësitë e tij sipas Konventës;

duke parë raportin e Sekretarit të Përgjithshëm mbi metodat e punës të Komitetit dhe të kapacitetit të tij për të realizuar mandatin e tij në mënyrë efikase, gjë e cila përfshinte një krahasim të organeve të tjera të traktateve;

duke mirëpritur përpjekjet e Komitetit për të përmirësuar më tej metodat e punës, duke miratuar vëzhgimet përfundimtare që përmbanin sugjerime dhe rekomandime specifike;

duke iu referuar faktit se, sipas nenit 17, paragrafi 9 i Konventës, Sekretarit të Përgjithshëm i kërkohet të sigurojë personelin dhe shërbimet e nevojshme për realizimin efikas të funksioneve të Komitetit;

duke iu referuar gjithashtu rezolutave të tij 44/73 të datës 8 dhjetor 1989, 45/124 të datës 14 dhjetor 1990 dhe 47/94 të datës 16 dhjetor 1992, ku ndër të tjera mbështeten fuqimisht pikëpamjet e Komitetit që Sekretari i Përgjithshëm duhet t'i japë më shumë prioritet forcimit të mbështetjes së Komitetit;

duke mbështetur fuqimisht rekomandimin e përgjithshëm nr.19 të Komitetit mbi dhunën ndaj grave dhe thirrjen drejtuar shteteve palë për të përgatitur raportet e tyre periodike në përputhje me këtë dhe me rekomandime të tjera të përgjithshme të Komitetit;

duke vërejtur me kënaqësi emërimin e një Raportuesi Special të Komisionit për të Drejtat e Njeriut mbi dhunën ndaj grave, duke përfshirë shkaqet dhe pasojat e saj:

1. Shpreh kënaqësinë e saj për rritjen e numrit të shteteve që kanë ratifikuar apo kanë aderuar në Konventën për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave dhe mbështet rekomandimin e përgjithshëm të Komitetit për Eliminimin e Diskriminimit ndaj Grave për të tërhequr vëmendjen ndaj atyre rezervave, të cilat janë të papajtueshme me objektivin dhe qëllimin e Konventës.

2. Nxiti të gjitha shtetet që nuk kanë ratifikuar ende apo nuk kanë aderuar në Konventë që ta realizojnë këtë sa më shpejt që të jetë e mundur.

3. Thekson rëndësinë e respektimit tepër të rreptë nga ana e shteteve palë të detyrimeve të tyre sipas Konventës.

4. Nxiti shtetet që të shqyrtojnë kufizimin e shkallës së çdo rezerve që ata vendosin ndaj Konventës, të formulojnë çdo rezervë sa më saktësisht dhe ngushtësisht që të jetë e mundur dhe të sigurojnë që asnjë rezervë nuk është e papajtueshme me objektin dhe qëllimin e Konventës ose që nuk është në kundërshtim me të drejtën ndërkombëtare.

5. I kërkon shteteve palë në Konventë që të shqyrtojnë rezervat e tyre në mënyrë të rregullt, me synimin e tërheqjes së tyre me shpejtësi, në mënyrë që Konventa të mund të zbatohet plotësisht.

6. Merr parasysh raportin e Sekretarit të Përgjithshëm për statusin e Konventës dhe i kërkon atij të vazhdojë të raportojë çdo vit pranë Asamblesë së Përgjithshme.

7. Merr parasysh gjithashtu raportet e Komitetit për Eliminimin e Diskriminimit ndaj Grave në sesionet e tij të dymbëdhjetë dhe të trembëdhjetë.

8. Rekomandon që shtetet palë në Konventë, duke marrë parasysh raportet e përmendura në paragrafët 6 dhe 7 më sipër, të shqyrtojnë situatën punuese të Komitetit dhe të kapacitetit të tij për të përmbushur mandatin e tij në mënyrë më efikase, dhe në këtë kontekst rekomandon gjithashtu që shtetet palë të shqyrtojnë mundësinë e ndryshimit të nenit 20 të Konventës, me qëllim që të lejohet kohë e mjaftueshme mbledhjesh për Komitetin.

9. I kërkon shteteve palë në Konventë që të takohen në vitin 1995 për të shqyrtuar rishikimin e nenit 20 të Konventës së përmendur në paragrafin 8 më sipër.

10. Fton shtetet palë në Konventë që të bëjnë të gjitha përpjekjet e mundshme për të dorëzuar raportin e tyre të parë, të dytë dhe raportet vijuese periodike për zbatimin e Konventës, në përputhje me nenin 18 dhe me udhëzimet e siguruara nga Komiteti, dhe të bashkëpunojnë plotësisht me Komitetin në paraqitjen e raporteve të tyre.

11. Mirëpret përpjekjet e bëra nga Komiteti për të racionalizuar procedurat e tij dhe për të përshpejtuar shqyrtimin e raporteve periodike dhe inkurajon fuqimisht Komitetin të vazhdojë këto përpjekje.

12. Mirëpret gjithashtu, në përputhje me rekomandimin nr.11 të Komitetit, iniciativat e ndërmarra për të siguruar kurse rajonale trajnimi për përgatitjen dhe hartimin e raporteve të shteteve palë për zyrtarët qeveritarë dhe trajnime dhe seminare informuese për shtetet që shqyrtojnë aderimin në Konventë dhe nxit organet dhe organizatat përkatëse të Kombeve të Bashkuara që të mbështesin iniciativa të tilla.

13. I kërkon Sekretarit të Përgjithshëm të vazhdojë përpjekjet e tij për të siguruar personelin e Sekretariatit, duke përfshirë anëtarë të personelit ligjor që janë ekspertë në zbatimin e traktateve për të drejtat e njeriut dhe burimet teknike, në mënyrë që Komiteti të realizojë me efikasitet funksionet e tij.

14. Mbështet fuqimisht pikëpamjen e Komitetit se Sekretari i Përgjithshëm duhet t'i japë më shumë prioritet, brenda burimeve ekzistuese, forcimit të mbështetjes teknike dhe materiale për Komitetin, në mënyrë të veçantë për të ndihmuar në studimin përgatitor.

15. I kërkon Sekretarit të Përgjithshëm të vazhdojë të sigurojë, të lehtësojë dhe të nxisë, brenda burimeve ekzistuese, shpërndarjen e informacionit në lidhje me Komitetin, vendimet dhe rekomandimet e tij, me Konventën dhe konceptin e njohurive ligjore, duke marrë parasysh rekomandimet e vetë Komitetit për këtë qëllim.

16. Mbështet kërkesat e Komitetit dhe të sesionit të dymbëdhjetë e të trembëdhjetë të tij për kohë shtesë për mbledhjet, me mbështetje të mjaftueshme nga Sekretariati, me qëllim që të mundësohet që Komiteti të mbledhet njëherë në vit për tri javë për sesionet e tij katërbëdhjetë e të pesëmbëdhjetë, dhe rekomandon që kërkesa e bërë nga Komiteti për kohë shtesë për mbledhjet të shqyrtohet brenda nivelit ekzistues të burimeve buxhetore.

17. I kërkon Sekretarit të Përgjithshëm të sigurojë mbështetje të mjaftueshme për Komitetin dhe gjithashtu të kërkojë që të sigurohen burime shtesë për këtë qëllim nga brenda buxhetit të rregullt ekzistues për të bërë të mundur që Komiteti të trajtojë në mënyrë të imtësishme dhe në kohë raportet që dorëzohen nga shtetet palë.

18. Vendos që në sesionin e tij të pesëdhjetënjëtë, ai do të shqyrtojë përsëri nëse puna e pakryer e Komitetit në lidhje me shqyrtimin e raporteve është reduktuar apo jo.

19. Rekomandon që mbledhjet e Komitetit të programohen, kurdo që është e mundur, që të lejojnë një transmetim në kohë të rezultateve të punës së tij pranë Komisionit për Statusin e Grave, për informacion në të njëjtin vit.

20. I kërkon Sekretarit të Përgjithshëm të dorëzojë pranë Asamblesë së Përgjithshme në sesionin e pesëdhjetënjëtë, një raport mbi zbatimin e rezolutës së tanishme dhe t'i vërë një raport në dispozicion Komisionit për Statusin e Grave në sesionin e tij të dyzetënjëtë.

Mbledhja plenare e 94-t
23 dhjetor 1994

Sesioni i pesëmbëdhjetë
Pika 165 e rendit të ditës

REZOLUTË E MIRATUAR NGA ASAMBLEJA E PËRGJITHSHME

Mbi Raportin e Komitetit të Tretë(A/50/816)

50/202. Ndryshimi i nenit 20, paragrafi 1 i Konventës për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave

Asambleja e Përgjithshme,

duke iu referuar rezolutës së saj 49/164 të datës 23 dhjetor 1994 mbi Konventën për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave¹ dhe vendimit të saj 49/448 të datës 23 dhjetor 1994 mbi shqyrtimin e kërkesës për rishikimin e nenit 20, paragrafi 1 i Konventës;

duke parë vendimin e shteteve palë në Konventën për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave të datës 22 maj 1995² për të ndryshuar nenin 20, paragrafi 1 të Konventës;

duke mirëpritur thirrjen për ratifikim të gjerë të këtij ndryshimi, në Platformën për Veprim të Konferencës së Katërt Botërore për Gratë³, e mbajtur në Pekin nga data 4 deri më 15 shtator 1995;

duke ritheksuar rëndësinë e Konventës, si dhe kontributin e Komitetit për Eliminimin e Diskriminimit ndaj Grave për përpjekjet e Kombeve të Bashkuara për të eliminuar diskriminimin ndaj grave:

1. Miraton rezolutën në lidhje me ndryshimin e nenit 20, paragrafi 1 i Konventës për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit ndaj grave, e miratuar nga shtetet palë të Konventës në datën 22 maj 1995;

2. Nxit shtetet palë të Konventës që të marrin masat e duhura, në mënyrë që të arrihet pranimi nga shtetet palë me shumicë prej dy të tretash sa më shpejt që të jetë e mundur, me qëllim që ndryshimi të hyjë në fuqi.

Mbledhja plenare e 99-të
22 dhjetor 1995

¹ Rezoluta 34/180, aneksi

² CEDAW/SP/1995/2, aneksi

³ A/CONF.177/20 dhe shtojca 1, kapitulli 1, rezoluta 1, aneksi II. 96-76879

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Gjergj Fishta”, mbrapa ish-eksponitës “Shqipëria Sot”, tel: 04 24 27 007.
Çmimi i abonimit pranë Postës Shqiptare, për Fletoret Zyrtare 2011, është 16 000 lekë.
Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

KODI CIVIL	360 lekë
KODI I FAMILJES	310 lekë
KODI I PROCEDURAVE ADMINISTRATIVE	90 lekë
KODI PENAL USHTARAK	55 lekë
KODI I PUNËS	140 lekë
KANONI I ZHURISË	40 lekë
PËRMBLEDHJE E VENDIMEVE TË GJYKATËS EUROPIANE	328 lekë
PËR TË DREJTAT E NJERIUT KUNDËR SHQIPËRISË	
PËRMBLEDHJE PËR KTHIMIN DHE KOMPENSIMIN E PRONAVE	140 lekë
PËRMBLEDHJE VENDIMESH UNIFIKUESE TË GJYKATËS SË LARTË	512 lekë

Hyri në shtyp më 25.2.2011
Doli nga shtypi më 28.2.2011

Tirazhi: 1700 copë

Formati: 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2011

Çmimi 40 lekë